



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE
INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK
TIRANE

Rruga: "Aleksander Moisiu", Nr 80, Tirana, Albania.

Tel: +355 4 237 4756, Fax 355 4 237 0058

RREGULLORE E BRENDSHME

Përmbajtja e dokumentit

1. Hyrje

2. Organizimi dhe funksionimi i ISHP

3. Misioni i ISHP

4. Funksionet e ISHP

5. Financimi i ISHP

6. Organet drejtuese të ISHP

(shih **Organigrama e ISHP**)

7. Sektoret mbështetës (financa, administrata, burimet njerëzore)

(shih **Organigrama e ISHP**)

8. Departamentet shkencore të ISHP

(shih **Organigrama e ISHP**)

9. Aneksë (Magazina; Vivariumi; Zyra e Radiombrojtjes)

(shih **Organigrama e ISHP**)

1. HYRJE

1.1. ETAPAT HISTORIKE:

1934: Laboratori Bakteriologjik i Shtetit (LBSH) (vendosje në ndërtesën aktuale të Fakultetit të Mjekësisë)

1946: LBSH emërtohet Laboratori i Bakteriologjise Humane (LBH) (vendosje në ndërtesën aktuale të Fakultetit të Mjekësisë, kati i dytë, së bashku me Laboratorin e Bakteriologjisë Veterinare, kati i parë)

1952: Mbi bazën e LBH krijohet Laboratori Qendror i Mikrobiologjisë Mjekësore (LQMM) (vendosje në ndërtesën aktuale të Drejtorisë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” [QSUT])

1954: Krijohet Laboratori Qendror i Higjienës Mjekësore (vendosje në të njejtën ndërtesë të LQMM)

1969: Mbi bazën e bashkimit të LQMM dhe LQMH krijohet Instituti i Higjienës dhe Epidemiologjisë (IHE) (ndërtesa aktuale me adnekeset përkatëse e ISHP)

1983: IHE emërtohet Instituti Kërkimor i Higjienës Epidemiologjisë dhe Prodhimeve Imunobiologjike (IKHEPI) për të përligjur *de jure* tiparin thelbësor kërkimor-shkencor të Institutit (VKM Nr. 152, date 15.04.1983).

1994: IKHEPI, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.313, date 19.06.1995, transformohet në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP), që thelbesisht përmban jo thjesht ndryshim emri, por ndryshim tërësor të vizionit-misionit-strukturës së Institutit, duke pasur krahas tiparit kërkimor-shkencor edhe atë universitar.

Me VKM Nr.178, datë 30.03.2001, Qendra Kombëtare e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit bashkohet me ISHP.

1.2. VEPRIMTARITË DHE SHËRBIMET E SHËNDETIT PUBLIK

Veprimtari bazë të shëndetit publik (neni 5, Ligji nr.10 138 “Për Shëndetin Publik”, datë 11.5.2009) janë:

- (i) Monitorimi i gjendjes shendetesore te popullates per te identifikuar problemet e saj.
- (ii) Diagnostikimi dhe hulumtimi i problemeve shendetesore dhe faktoreve risk ne popullate.
- (iii) Vleresimi i efektivitetit, perdorimit dhe cilesise se sherbimeve shendetesore ndaj individit dhe komunitetit.
- (iv) Zhvillimi i politikave dhe planeve qe mbeshtesin perpjekjet shendetesore te individit dhe komunitetit.
- (v) Perforcimi i ligjeve dhe rregulloreve qe mbrojne shendetin dhe e sigurojne ate si dhe kapacitetet zbatuese.
- (vi) Hulumtimi per njohuri dhe zgjidhje te reja te problemeve shendetesore.
- (vii) Promovimi dhe mbeshtetja e aksesit te barabarte ne sherbimet baze te kujdesit shendetesor.
- (viii) Sigurimi dhe zhvillimi, nepermjet trajnimit te vazhdueshem i burimeve njerezore ne shendetin publik.
- (ix) Informimi, edukimi dhe ndergjegjesimi i popullates rreth ceshtjeve shendetesore.
- (x) Mobilizimi i popullates per identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve shendetesore si dhe promovimin e shendetit.
- (xi) Pergatitja, planifikimi dhe marrja e masave zbutëse për përballimin e emergjencave civile si dhe fatkeqesive natyrore ose te shkaktuara nga njeriu.

Paketa e shërbimeve të shëndetit publik (neni 6, Ligji nr.10 138 “Për Shëndetin Publik”, datë 11.5.2009):

1. Paketa e shërbimeve të shëndetit publik përfshin shërbimet bazë dhe shërbimet ndihmëse të shëndetit publik që janë në funksion të zgjidhjes së problemeve dhe nevojave të shëndetit të popullatës.
2. Paketa e shërbimeve ndihmëse të shëndetit publik miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Shërbimet bazë të shëndetit publik (neni 7, Ligji nr.10 138 “Për Shëndetin Publik”, datë 11.5.2009)

1. Shërbimet bazë të shëndetit publik janë:
 - (i) promovimi i shëndetit;
 - (ii) edukimi shëndetësor;
 - (iii) parandalimi i sëmundjeve, përfshirë imunizimin, depistimin;
 - (iv) siguria ushqimore;
 - (v) shëndeti në punë;
 - (vi) shëndeti mjedisor, përfshirë monitorimin e mbetjeve urbane;
 - (vii) shëndeti riprodhues, përfshirë shëndetin e nënës, të fëmijës dhe shëndetin seksual;
 - (viii) parandalimi dhe kontrolli i përdorimit abuziv të substancave (produktet e duhanit, alkool, lëndë narkotike dhe psikotrope etj.);
 - (ix) shëndeti mendor;
 - (x) sistemi i informacionit në shëndetin publik;
 - (xi) survejanca epidemiologjike në shëndetin publik;
 - (xii) laboratorët e shëndetit publik;
 - (xiii) monitorimi i shërbimeve të shëndetit publik në kujdesin shëndetësor parësor;
 - (xiv) kërkimi shkencor në shëndetin publik;
 - (xv) trajnimet në shëndetin publik.
2. Shteti, nëpërmjet institucioneve kompetente, merr masa për garantimin e shërbimeve bazë të shëndetit publik.

2. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ISHP

Instituti i Shendetit Publik organizohet dhe funksionon ne baze te ligjit Nr.10 138, datë 11.5.2009, “Per Shëndetin Publik”.

ISHP, ne varesi dhe mbeshtetje te Ministrise se Shendetesise, eshte institucion kerkimor shkencor qe pergjigjet per sigurimin dhe mbrojtjen e shendetit te komunitetit, duke siguruar informacion te besueshem, duke nxitur e sugjeruar vendime politike ne shendetesi dhe duke promovuar shendetin ne bashkepunim me institucionet kombetare dhe ato nderkombetare.

Organizimi, misioni, pergjegjësitë, funksionet dhe financimi i ISHP percaktohen ne ligjin nr.10 138 “Për Shëndetin Publik”, datë 11.5.2009.

ORGANIZIMI I ISHP

Instituti i Shendetit Publik (ISHP) eshte institucion publik, buxhetor, ne varesi administrative nga Ministria e Shendetesise (neni 12, Ligji “Per Shendetin Publik”, nr.10 138, datë 11.5.2009).

Instituti i Shendetit Publik eshte qender e kerkimit shkencor ne shendet publik, qender reference e sherbimeve ne fushen e shendetit publik, qender universitare e trajnimit ne shendet publik dhe qender e informacionit ne shendet publik (neni 12, Ligji “Per Shendetin Publik”, nr.10 138, datë 11.5.2009).

3. MISIONI I ISHP

ISHP ka detyre te kontrolloje dhe parandaloje semundjet si dhe te studjone mjedisin dhe efektin e tij mbi shendetin e komunitetit nepermjet:

- (i) Veprimtarise se gjere kerkimore e shkencore dhe studimeve ne fushen e epidemiologjise, imunologjise, mikrobiologjise, mjedisit, promocionit te shendetit, ekspertizes etj, per te ofruar zgjidhje inovative te problemve shendetesore dhe per ndertimin e strategjive efektive per parandalimin dhe kontrollin e semundjeve.
- (ii) Monitorimit te gjendjes shendetesore per te identifikuar, analizuar shkaqet dhe zgjidhur ne kohe problemet dhe rreziqet per shendetin e popullates.
- (iii) Informimit, edukimit dhe ndergjegjesimit te komunitetit per problemet shendetesore dhe rruget e zgjidhjes se tyre.
- (iv) Nxitjes dhe mbeshtetjes se projektligjeve, rregulloreve dhe standarteve te cilat synojne mbrojtjen e shendetit dhe sigurine shendetesore.
- (v) Sigurimit te edukimit te vashdueshem, kualifikimit dhe mbeshtetjes profesionale per specialistet e shendetit publik.
- (vi) Vleresimit te efektivitetit dhe cilesise se sherbimeve shendetesore duke synuar arritjen e standardeve bashkekohore .
- (vii) Bashkepunimit me institucione nderkombetare analoge duke shkëmbyer eksperience dhe pervojte te perparuar si dhe duke specializuar e trajnuar specialiste ne fusha te ndryshme.

PËRGJEGJËSITË E ISHP (neni 14, Ligji “Per Shendetin Publik”, nr.10 138, datë 11.5.2009).

Instituti i Shëndetit Publik është përgjegjës për:

- Informimin, keshillimin dhe mbeshtetjen e Ministrise se Shendetesise ne hartimin e politikave dhe strategjive ne fushen e shendetit publik.

- Sigurimin e ekspertizave ne shendet publik.
- Realizimin e studimeve te pavarura dhe prodhimin e informacioneve bazuar ne fakte.
- Pjesëmarrjen ne formimin e burimeve njerezore ne shendet publik.

Instituti i Shëndetit Publik mbështet Ministrinë e Shëndetësisë dhe strukturat rajonale të shëndetit publik për realizimin e funksioneve dhe shërbimeve të shëndetit publik.

MARRËDHËNIA E STRUKTURAVE RAJONALE TË SHËNDETIT PUBLIK ME ISHP

Marrëdhënia e strukturave rajonale të shëndetit publik me ISHP realizohen si me poshte:

1. Strukturat rajonale të shëndetit publik i referohen Institutit të Shëndetit Publik për ekspertizë, shërbime të specializuara dhe zhvillim profesional në fushën e shëndetit publik.
2. Strukturat rajonale të shëndetit publik dërgojnë informacion në Institutin e Shëndetit Publik. Mënyra e informimit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë (bazuar ne nenin 23, te ligjit 10 138 "Per shendetin Publik", date 11.5.2009).

4. FUNKSIONET E ISHP

Funksionet baze te Institutit te Shendetit Publik, (bazuar ne nenin 15, Ligji “Per Shendetin Publik”, nr.10 138, datë 11.5.2009), jane:

- 1) Mbikqyrja, vleresimi dhe persosja e veprimtarise profesionale te strukturave lokale ne fushen e shendetit publik.
- 2) Observatori Epidemiologjik Kombetar.
- 3) Prodhimi i indikatoreve te shendetit.
- 4) Survejanca e integruar e semundjeve infektive.
- 5) Programit Kombetar i Vaksinit.
- 6) Mbikqyrja dhe vleresimi i infeksioneve spitalore dhe menaxhimit te mbetjeve spitalore (ne bashkepunim me Strukturat Rajonale te Shendetit Publik).
- 7) Qender e sigurimit dhe kontrollit te cilesise te laboratoreve te shendetit publik.
- 8) Programi Kombetar i HIV/AIDS dhe qendër referente në fushen e shëndetit publik për HIV/AIDS dhe IST.
- 9) Programi i Kontrollit te Tuberkulozit.
- 10) Programi i koordinimit te luftes kunder vektoreve.
- 11) Qender e laboratoreve te references per semundjet infektive me rrezikshmeri te larte dhe qendër referente në fushen e shëndetit publik për semundjet zoonotike me transmetim vektorial.
- 12) Qendra kombetare per koordinimin dhe zbatimin e Rregullores Nderkombetare te Shendetit.
- 13) Qendër referente në fushen e shëndetit publik për promovimin dhe edukimin shëndetësor.
- 14) Observatori kombetar i faktoreve te riskut per semundjet jo te komunikueshme dhe barres se semundjeve jo te komunikueshme. Qender administrimi e regjistrave te semundjeve jo te komunikueshme.
- 15) Qendra Kombetare e Sistemit te Informacionit per Drogen.
- 16) Qender referente per vleresimin e ndikimit te mjedisit ne shendet.
- 17) Qender referente laboratorike ne monitorimin e ujit, ajrit, zhurmave.
- 18) Qender referente e vleresimit te faktoreve te demshem per shendetin ne pune.

- 19) Qender e analizes se politikave dhe praktikave nderkombetare ne shendet publik.
- 20) Qender referente e kerkimit shkencor ne shendet publik.
- 21) Qender referente e edukimit ne vazhdim ne shendet publik.
- 22) Qender operative dhe implementuese e programeve te shendetit publik ne raste te percaktuara nga Ministri i Shendetesise.

5. FINANCIMI I ISHP

Instituti i Shëndetit Publik, (bazuar ne nenin 16, Ligji nr.10 138 “Për Shëndetin Publik, datë 11.5.2009), financohet nga:

1. Buxheti i Shtetit.
2. Të ardhura nga veprimtari shkencore apo edukative.
3. Grante, fonde për veprimtari shkencore, programe zhvillimi.
4. Donacione.
5. Burime të tjera të ligjshme.


ORGANIGRAMA E ISHP

ISHP funksionon ne baze te organikes dhe struktures se miratuar nga Ministria e Shendetesise, (shih Organigramen e ISHP).

Organigrama e ISHP paraqet ne menyre te detajuar:

- Strukturen perberese;
- Vartesite hierarqike;
- Nderlidhjet ne brendi te struktures te elementeve perberes te saj.

ORGANIGRAMA E INSTITUTIT TE SHËNDETIT PUBLIK (ISHP) - 2013 [=Institucioni Kombëtar Kërkimor-Shkencor dhe Universitar i Shëndetit Publik]



6. ORGANET DREJTUESE te ISHP-se

6.1. Struktura organizative (neni 13, Ligji nr.10 138 “Për Shëndetin Publik”, datë 11.5.2009)

1. Organet drejtuese te ISHP jane:

- **Drejtoria**
- **Keshilli Shkencor**

2. Veprimtaria dhe aktiviteti i përditshëm i ISHP drejtohet nga **Drejtori, Nën/drejtori Teknik, Nën/drejtori Ekonomik, dhe Shefat e Departamenteve dhe Shefat e Sektorëve.**

3. Struktura organizative e ISHP permban edhe Keshillin Drejtues ne perberje te saj. **Keshilli Drejtues i ISHP** eshte organ keshillimor i drejtorit te ISHP. Ai perbehet nga dy Nen/Drejtoret, Shefat e Departamenteve shkencore, pergjegjesi i zyres se burimeve njerezore, dhe shefi i sektorit te administrates. Ne mbledhjet e tij çdojavore, Keshilli Drejtues shqyrton dhe diskuton mbi aktivitetin javor te ISHP dhe problemet perkatese te shtruara per zgjidhje.

6.2. KESHILLI SHKENCOR I ISHP-se

Keshilli Shkencor i ISHP organizohet dhe funksionon ne baze te Vendimit te Keshillit te Ministrave (VKM), Nr. 380, date 18.5.2011 “Per Ngritjen, Organizimin dhe Menyren e Funksionimit te Keshillit Shkencor te Institutit te Shendetit Publik”, (perpiluar ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise dhe te pikes 3, te nenit 13, te Ligjit “Per Shendetin Publik”, nr. 10 138, date 11.5.2009).

Sipas VKM-se se mesiperme Nr. 380, date 18.5.2011:

1. Keshilli Shkencor (KSH) i Institutit te Shendetit Publik (ISHP) ngrihet si organ keshillimor i ketij instituti.
2. KSH-ja drejton punen ne ISHP duke percaktuar perpaesite dhe duke vleresuar cilesine dhe frytshmerine e punes se kryer. Ky keshill, gjithashtu, vlereson vlefshmerine shkencore dhe etiken e programeve te kerkimit apo te nderhyrjes, programet e edukimit ne vazhdim ne fushen e shendetit publik, si dhe drejton plane te zhvillimit strategjik, strukturor, teknologjik dhe te burimeve njerezore ne ISHP.
3. Keshilli Shkencor i ISHP-se kryesohet nga drejtori i ketij instituti dhe ka ne perberje anetare te brendshem dhe anetare te jashtem. Anetaret e brendshem (6 persona), qe emerohen nga drejtori i ISHP-se, jane specialiste me grade dhe/ose titull shkencor dhe, njeheresh, figura me eksperience te pasur ne kerkimin/studimin shkencor, menaxhimin/udheheqjen teknike-shkencore dhe aktivitetin trajnues-akademik ne fushen e shendetit publik. Anetaret e jashtem (8 persona) jane perfaqesues nga Ministria e Shendetesise (1), Fakulteti i Mjekesise (Universiteti i Tiranes) (3), Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit (1), Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave (1), Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta (1), dhe Ministria e Arsimit dhe Shkences (1).

Perberja nominale e mesiperme miratohet nga Kryetari i Keshillit te Ministrave.

4. KSH-ja mblidhet ne menyre te rregullt, te pakten dy here ne vit, per te analizuar dhe vleresuar punen e kryer nga ISHP-ja dhe per te drejtuar perpaesite dhe veprimtarite e ardhshme.

Ministri i Shendetesise, kur e sheh te arsyeshme, merr pjese ne mbledhjet e KSH te ISHP.

5. Sekretari i KSH caktohet nga drejtuesi i ketij keshilli dhe ka detyra te percaktuara qarte ne VKM-ne e lartpermendur Nr. 380, date 18.5.2011.

Këshilli Shkencor ka si funksion:

- 1) Të hartojë strategjinë, planet (afat-shkurtra dhe afat-gjata), programet dhe prioritetet e zhvillimit te ISHP-se, në përputhje me politikat kombëtare shëndetësore të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë.
- 2) Te shqyrtoje dhe te keshilloje Drejtorine mbi marrëveshjet e bashkëpunimit te ISHP me institucione dhe organizma jashtë dhe brenda vendit.
- 3) Te paraqesë dhe të propozojë përpara Ministrisë së Shëndetësisë projekt-aktet normative.
- 4) Të shqyrtoje dhe vleresoje planet dhe programet për zhvillimin, trajnimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në përputhje me politikat e përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë.
- 5) Të analizoje dhe hartojë ndryshimet strukturore në ISHP.
- 6) Të percaktojë kriteret per pozicionet drejtuese (shef departamenti, shef sektori) ne ISHP dhe te shqyrtoje zbatimin e ketyre kriterëve nga Drejtori i ISHP-se ne emerimin e Shefave te Departamenteve shkencore dhe nga Shefat e Departamenteve shkencore ne emerimin (me miratimin e Drejtorit te ISHP-se) e Shefave te Sektoreve shkencore perberes te Departamentit perkates.
- 7) Të analizoje dhe te propozojë mbi rekrutimin e stafit te ri dhe zhvillimin e tij profesional.
- 8) Te shqyrtoje dhe orientoje mbi prioritetet dhe procesin e botimeve shkencore që nxjerr vete ISHP.

6.3. DREJTORI

Emërimi

1. Emërimi dhe lirimi i Drejtorit të ISHP bëhet nga Ministri i Shëndetësisë.
2. Kriteret për emërimin e Drejtorit të ISHP-se janë në përputhshmeri të plote me funksionet e ISHP-se të përcaktuara ligjrisht: *“Instituti i Shëndetit Publik është qender e kërkimit shkencor në shëndet publik, qender reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qender universitare e trajnimit në shëndet publik dhe qender e informacionit në shëndet publik”* (neni 12, Ligji “Për Shëndetin Publik”, nr.10 138, datë 11.5.2009). Rrjedhimisht, kriteret për emërimin e Drejtorit të ISHP-se janë:
 - (i) Mjek,
 - (ii) Specializim pasuniversitar në fushën e Shëndetit Publik,
 - (iii) Të paktën Grada Shkencore “Doktor i Shkencave” (me përparësi praninë e Titujve Shkencore “Profesor” apo/dhe “Profesor i asocijuar”),
 - (iv) Eksperiencë në aktivitetin shkencor dhe akademik në fushën e Shëndetit Publik.
3. Drejtori mund të shkarkohet nga detyra, atëherë kur kryen veprime ose mosveprime, që janë në kundërshtim me ligjet dhe aktet në fuqi apo dhe me rregulloren e ISHP-së. (bazuar në kodin e punës)

Funksionet e Drejtorit

Drejtori i ISHP-se:

- (i) Është titullari i ISHP-se.
- (ii) E ushtron veprimtarinë e tij konform ligjeve në fuqi, vendimeve të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Shëndetësisë, dhe detyrave të përcaktuara nga kjo rregullore.
- (iii) Siguron realizimin e objektivave dhe detyrave profesionale dhe ekonomike dhe përgjigjet periodikisht para Ministrisë së Shëndetësisë për tërë veprimtarinë e ISHP-se.
- (iv) Organizon, bashkërendon dhe kontrollon veprimtarinë e përgjithshme të ISHP dhe e përfaqëson atë.
- (v) Është kryetar i Këshillit Shkencor të ISHP-së.

- (vi) Është kryetar i Keshillit Drejtues të ISHP-se.
- (vii) Është personi juridik, zyrtar, i autorizuar, i cili ushtron detyrën e tij drejtpërdrejt duke drejtuar e kontrolluar aktivitetin e ISHP-së, nëpërmjet aktiviteteve zbatuese e administrative, duke u dhënë detyra dhe udhëzime vartësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.
- (viii) Miraton politika, strategji, plane, programe dhe prioritetet shëndetësore, të diskutuara në Keshillin Shkencor, në bazë të politikës dhe strategjisë kombëtare shëndetësore të Ministrisë së Shëndetësisë.
- (ix) Menaxhon, mbikqyr dhe koordinon shërbimet/departamentet/sectorët e ISHP.
- (x) Miraton treguesit financiarë të projekt buxhetit të përgatitur e hartuar nga sektori i Finances; ndarjen dhe destinacionin e fondeve buxhetore të financuara; mënyrat, format e evidentimit dhe kontrollit të administrimit të këtyre fondeve sipas legjislacionit në fuqi për buxhetin e shtetit dhe udhëzime të ndryshme në zbatim të tyre.
- (xi) Miraton dhe ndjek zbatimin mbi planet dhe programet për zhvillimin, kualifikimin, dhe administrimin e burimeve njerëzore në përputhje me politikën e Ministrisë së Shëndetësisë.
- (xii) Në përputhje dhe zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, nxjerr urdhëra dhe udhëzime të brendshme, të detyrueshme për zbatim.
- (xiii) Miraton të gjitha programet dhe materialet të ISHP-se, që i paraqiten Ministrisë së Shëndetësisë dhe organeve të tjera të larta shtetërore si dhe institucioneve të tjera analoge vendase ose të huaja.
- (xiv) Miraton planet e punës, objektivat dhe projektet e departamenteve të ISHP, të shqyrtuara paraprakisht në Keshillin Shkencor.
- (xv) Miraton propozimet për lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e shëndetësisë, në përputhje me qëllimin dhe misionin e ISHP si dhe përgjigjet për realizimin e detyrimeve kontraktore që rrjedhin prej tyre.
- (xvi) Emëron dhe shkarkon shefat e departamenteve, bazuar në kriteret e miratuara nga Keshilli Shkencor dhe legjislacioni në fuqi.
- (xvii) Emëron dhe shkarkon punonjësit e ISHP, bazuar në kriteret e miratuara nga Keshilli Shkencor dhe legjislacioni në fuqi.
- (xviii) Miraton përbërjen e të gjitha komisioneve konsultative (te perkohshme) të ISHP.
- (xix) Mbikqyr aktivitetin burimeve njerëzore sipas legjislacionit në fuqi.

- (xx) Në përputhje me aktet ligjore, jep masa administrative dhe ndëshkuese ndaj punonjësve që shkelin disiplinën në punë.
- (xxi) Kontrollon, ndan detyra dhe merr informacion lidhur me aktivitetin e ISHP nëpërmjet mbledhjeve periodike javore të Keshillit Drejtues.
- (xxii) Në rastet kur Drejtori largohet për punë jashtë shtetit ose merr lejen vjetore, ngarkon Nen/drejtorin Teknik si Zëvendës të tij, për aq kohë sa do të zgjasë largimi i tij.

Asistenti i Drejtorit

- Mban evidencën e porosive që merr prej Drejtorisë për punonjësit e aparatit dhe ndjek përfundimin e dhënies së përgjigjes.
- Mban protokollin në takimet që Drejtorin bën me Shefat e Departamenteve, ose me persona të tjerë.
- Koordinon takimet e planifikuara për Drejtorinë dhe pret personat që kërkojnë takim me titullarin (punonjësit e ISHP-së ose persona të jashtëm).
- Evidenton problemet dhe detyrat kryesore të dala nga dosja e shqyrtuar nga Drejtori dhe i protokollon ato (ose i dërgon në zyrën e protokollit për shpërndarje).

6.4. NËN/DREJTORËT (TEKNIK DHE EKONOMIK)

6.4.1. NËN/DREJTORI TEKNIK

Nën/Drejtori Teknik propozohet nga Drejtori ISHP dhe miratohet nga Ministri i Shëndetësisë.

Kriteret për emërimin e Nen/Drejtorit Teknik janë në përputhshmeri të plote me funksionet e ISHP-se të percaktuara ligjrisht: *“Instituti i Shëndetit Publik është qender e kerkimit shkencor në shëndet publik, qender referencë e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qender universitare e trajnimit në shëndet publik dhe qender e informacionit në shëndet publik”* (neni 12, Ligji “Për Shëndetin Publik”, nr.10 138, datë 11.5.2009). Rrjedhimisht, kriteret për emërimin e Nen/Drejtorit Teknik të ISHP-se janë:

- (i) Mjek,
- (ii) Specializim pasuniversitar në fushën e Shëndetit Publik,
- (iii) Të paktën Grada Shkencore “Doktor i Shkencave” (me përparësi pranë e Titujve Shkencore “Profesor” apo/dhe “Profesor i asociuar”),
- (iv) Eksperiencë në aktivitetin shkencor dhe akademik në fushën e Shëndetit Publik.

Detyrat/funksionet e Nën/Drejtorit Teknik

Nën/Drejtori Teknik:

- (i) Bashkërendon aktivitetin shkencor të ISHP-se nëpërmjet bashkërendimit të punës ndërmjet departamenteve shkencore të ISHP-se, ushtron kontroll dhe kërkon llogari nga shefat përkatës, dhe ndihmon ata në zgjidhjen e problemeve ku nevojitet autoriteti i postit drejtues të tij.
- (ii) Bashkërendon punën me organizmat/organizatat donatore për realizimin e projekteve dhe kontrollon zbatimin e tyre.
- (iii) Mban përgjegjësi për mbarëvajtjen e punës dhe raporton para Drejtorit për Departamentet që mbulon në lidhje me realizimin e detyrave të ngarkuara.

- (iv) Njihet me të gjitha materialet e Departamenteve që mbulon, kontrollon nëse janë sipas kërkesave, jep vlerësim për çështjet e trajtuara dhe i miraton ato.
- (v) Merr informacion nga juristi për aktet ligjore dhe nënligjore, urdhërat dhe udhëzimet e Ministrisë Shëndetësisë apo organeve të tjera qendrore dhe ju a përcjell për njohje dhe zbatim stafit të ISHP-se.
- (vi) Përgatit materialet që do të bëhen të njohura publikisht, sigurohet për saktësinë e informacioneve të nevojshme në masmedia lidhur me veprimtarinë e ISHP-së.
- (vii) Perfaqeson në mënyrë dinjitoze dhe profesionale ISHP-në në marrëdhëniet me institucionet vendase apo të huaja, për problemet shkencore, kur kjo i delegohet nga Drejtori i ISHP-se.
- (viii) Promovon dhe nxit kapacitetet analitike të Institutit të Shëndetit Publik, në funksion të ofrimit të më shumë shërbimeve për subjektet publike dhe private.
- (ix) Monitoron dhe organizon shërbimet e ofruara për rritjen e të ardhurave të institucionit.
- (x) Ndjek administrativisht dhe siguron respektimin e marrëdhënieve ndërinstucionale gjatë procesit të ofrimit të shërbimeve për të tretët.
- (xi) Monitoron nga ana administrative programet dhe projektet në shërbim të ministrive të tjera.
- (xii) Monitoron dhe planifikon në bashkëpunim me Departamentet, shërbimet që kryen ISHP-ja në funksion të strukturave rajonale të shëndetit publik.
- (xiii) Kujdeset për rrjetin kompiuterik, telefonik dhe faqen e internetit të ISHP.

Drejtori i ISHP-se i delegon Nen/Drejtorit Teknik edhe detyra të tjera sipas rastit dhe nevojave të institucionit.

6.4.2. NËN/DREJTORI EKONOMIK

Nën/Drejtori Ekonomik propozohet nga Drejtori i ISHP-se dhe miratohet nga Ministri i Shëndetësisë. .

Nën/Drejtori Ekonomik ka për detyre:

- (i) Të mbështesë Drejtorin e ISHP-se dhe Departamentet perkatese në përcaktimin e strategjive të institucionit, vlerësimin e mundësive specifike dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare të tij.
- (ii) Të asistojë dhe të administrojë fondet buxhetore së bashku me Drejtorin, bazuar në analizën e nevojave të departamenteve të institutit.
- (iii) Të funksionojë si anëtar i ekipit të menaxhimit, nëpërmjet pjesëmarrjes në diskutime dhe kontributit krijues në proceset e menaxhimit dhe kryesisht në mbështetjen e ofruar për Departamentet brenda ISHP-se.
- (iv) Të drejtojë procesin e hartimit të buxhetit vjetor për ISHP-ne, dhe të mbështesë Drejtorin e ISHP-se në argumentimin e tij pranë Ministrisë së Shëndetësisë.
- (v) Të drejtojë procesin e analizës financiare vjetore, duke garantuar saktësinë e të dhënave financiarë dhe rregullimet në buxhetin e vitit.
- (vi) Të përgatisë raporte për qeverinë (Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Financave) dhe të garantojë përputhshmëri me ligjshmërinë financiare të qeverisë.
- (vii) Të analizojë dhe të marrë pjesë në negociatat e kontratave me donatorët si dhe të monitorojë buxhetimin e aktiviteteve të projekteve/programeve të ndryshme të financuar nga donatorët
- (viii) Të administrojë fondet buxhetore dhe të donatorëve të cilat do të menaxhohen nëpërmjet procedurat e prokurimeve në zbatim të ligjslacionit përkatës në fuqi.

Drejtori i ISHP-se i delegon Nën/Drejtorit Ekonomik edhe detyra të tjera sipas rastit dhe nevojave të institucionit.

6.5. KËSHILLI DREJTUES I ISHP-se

- (i) **Keshilli Drejtues i ISHP** eshte organ keshillimor i drejtorit te ISHP.
- (ii) Ai perbehet nga
 - dy Nen/Drejtoret (Teknik dhe Ekonomik),
 - Shefat e Departamenteve Shkencore,
 - Pergjegjesi i Zyres se Burimeve Njerezore,
 - Shefi i Sektorit te Administrates,
 - Shefi i Sektorit te Finances.
- (iii) Drejtori i ISHP-se (dhe, ne mungese te tij, Nen/Drejtori Teknik), organizon dhe drejton mbledhjet e rregullta çdojavore te Keshillit Drejtues.
- (iv) Ne mbledhjet e tij çdojavore, Keshilli Drejtues shqyrton dhe diskuton mbi aktivitetin javor te ISHP dhe problemet perkatese te shtruara per zgjidhje.
- (v) Per probleme te vecanta, Drejtori therret per pjesemarrje ne mbledhjen e Keshillit Drejtues edhe specialist/e perkates te ISHP-se.
- (vi) Asistenti i Drejtorit te ISHP-se luan rolin e sekretarit te Keshillit Drejtues.

7. SEKTORËT MBËSHTETËS (FINANCA, ADMINISTRATA, BURIMET NJERËZORE)

7.1. SEKTORI I FINANCËS

Veprimtaria e Sektorit të Finances administrohet nga Nen/Drejtori Ekonomik dhe menaxhohet nga Shefi i Sektorit të Finances.

Sektori i Finances ka per detyre:

- Të drejtojë, kordinojë dhe ndjekë veprimtarinë ekonomiko-financiare të ISHP në përputhje me ligjet në fuqi.
- Të ruajë me rigorozitet të gjithë informacionet ekonomike të projekteve të ndryshme kërkimore e shkencore.
- Të bëjë vlerësimin financiar të programeve të ndryshme kërkimore e shkencore apo iniciativave operative.
- Të përgatisë nën drejtimin dhe në bashkëpunim me Nën/Drejtorin Ekonomik planet financiare për programe të rëndësishme që mbulon dhe ndjek ISHP-ja.
- Të përfaqësojë në mënyrë dinjitoze dhe profesionale ISHP-në në marrëdhëniet me institucionet vendase apo të huaja për problemet ekonomike dhe financiare.

Shefi i Sektorit të Finances ka per detyre:

- Të mbajë, dhe kordinojë ndjekjen dhe zbatimin e legjislacionit financiar në regjistrimin e librave kontabël.
- Të krijojë dhe të mbyllë bilancin vjetor të aktivitetit ekonomik të ISHP-se në përputhje me ligjin e kontabilitetit, ligjin e buxhetit dhe legjislacionet përkatëse në fuqi.
- Të përgatisë informacione financiare për Nën/Drejtorin Ekonomik, në lidhje me aktivitetin ekonomik të ISHP-se, si dhe të marrë pjesë në hartimin e projekt-buxhetit duke plotësuar informacionet teknike-financiare.

- Te hartoje statistikat dhe pasqyratë perkatëse financiare per Ministrinë e Shendetesise dhe Thesarin.
- Te ndjeke dhe të zbatojë procedurat financiare per realizimin e aktiviteteve të ndryshme në kuadër te projekteve nga donatore te ndryshem.
- Të koordinojë punën në sektorin e finances.
- Te realizoje cdo detyre tjeter shtese qe i ngarkohet me urdher nga Drejtori dhe Nen/Drejtori Ekonomik.

Finacieri (Ekonomisti) duhet:

- Të mbajë dhe të regjistrojë veprimet dhe transaksionet financiare në librat e llogarive përkatëse (si ditarin e thesarit, regjistrimin e ditarit të arkës, ndjekjen e llogarive analitike furnitore, debitore, kreditore, regjistrimine e asetëve, etj), në zbatim te legjislacionit përkatës në fuqi.
- Të menaxhojë dhe të përlllogarisë pagat, sigurimet shoqerore në zbatim te legjislacionit përkatës dhe urdhërave të Pergjegjesit te Zyres së Burimeve Njerëzore dhe Drejtorit, si dhe të kryejë regjistrimet në sistemet online dhe kontabilizimin e tyre në regjistrat përkatës.
- Të marrë pjesë në mbylljen e bilancit se bashku me Shefin e Sektorit te Finances.
- Të përgatisë informacione si dhe raporte për Shefin e Sektorit te Financës.
- Te kryeje cdo detyre tjeter shtese qe i ngarkohet me urdher nga Shefi i Sektorit te Finances dhe/ose Drejtori apo Nen/Drejtori Ekonomik.

7.2. SEKTORI I ADMINISTRATËS

Spektori i Administratës (Shefi i Sektorit te Administratës) varet nga Drejtori i ISHP-së dhe përgjigjet para tij.

Shefi i Sektorit te Administratës organizon, drejton dhe përgjigjet për realizimin dhe mbarëvajtjen e punës brenda Institucionit dhe ka këto detyra:

- Siguron ruajtjen e godinës së institucionit me shërbim roje 24 orë duke bashkërenduar punën me policinë e objekteve.
- Siguron rregull e qetësi brenda godinës së institucionit.
- Organizon, kontrollon dhe përgjigjet për të siguruar pastërti shembullore dhe mjedis të kulturuar në institucion.
- Organizon punën dhe përgjigjet për të siguruar dhe gadishmërinë dhe funksionin normal të pajisjeve hidrosanitare, elektrike, elektronike, telefonike, të ngrohjes, mjeteve të transportit.
- Organizon punën dhe përgjigjet për të siguruar dhe gadishmërinë dhe funksionin normal mjeteve të transportit.
- Organizon punën dhe përgjigjet për lëvizjen e automjeteve të institucionit vetëm për qëllime pune. Për këtë, siguron dhe përgjigjet për shpërndarjen e sasive të karburantit për çdo automjet në përputhje të plotë me urdhër-shërbimet dhe programin e punës të miratuar nga Drejtori i ISHP-se.
- Organizon punën dhe përgjigjet për të siguruar dhe kompletuar të gjitha zyrat me pajisjet, inventarin dhe kancelaritë e domosdoshme për nevoja pune, sipas kërkesave të bëra dhe urdhërave e prokurimeve të dhëna nga Drejtori i ISHP-se.
- Organizon punën dhe përgjigjet për të siguruar sigurim dhe funksionim normal të mjediseve të punës në institucion. Studion dhe propozon rrugë e masa për përmirësimin e mjediseve të punës në ISHP me qëllim që të sigurohen standardet bashkëkohore.
- Merr masa për të siguruar mbrojtje sa më efektive për institucionin kundër zjarrit, sipas dispozitave në fuqi.
- Organizon punën, merr masa dhe ndërton një sistem mbrojtës për ruajtjen e shëndetit të punonjësve.

- Merr masa rigoroze për të siguruar në shkallën më të lartë ruajtjen e të gjitha materialeve biologjike, toksike, radioaktive, të cilësuar tepër të rrezikshme për shëndetin e punonjësve, si dhe mospërhapjen e tyre jashtë institucionit.
- Informon sistematikisht me shkrim Drejtorin e ISHP-se për punën e kryer dhe detyrat që dalin.

Drejtori i ISHP-se i delegon dhe detyra të tjera sipas rastit dhe nevojave të institucionit.

7.3. ZYRA E BURIMEVE NJERËZORE

Zyra e Burimeve Njerezore (Pergjegjesi i saj) varet nga Drejtori i ISHP-së dhe përgjigjet para tij per te gjitha problemet qe lidhen me personelin e ISHP-se.

Nga ana teknike, Zyra e Burimeve Njerezore e ISHP-se ka vartesi teknike nga Drejtoria e Burimeve Njerezore e Ministrise se Shendetesise.

Pergjegjesi i Zyres se Burimeve Njerezore organizon, drejton dhe përgjigjet për realizimin dhe mbarëvajtjen e punës brenda Institucionit lidhur me personelin (punonjesit e ISHP-se) dhe ka këto detyra:

- Mban pergjegjesi per sistemimin dhe drejtimin e personelit, ben identifikimin e nevojave per personelin apo personelin e tepert, rekrutimin, risistemimin e personelit ne perputhje me legjislacionin, trajnimin e fillestareve dhe ate te punonjesve te tjere, ecurine profesionale, motivimin e punonjesve dhe pagat, organizimin e strukturave, studion ne c'menyre dhe ne c'mase mund te permiresohen strukturat organizative dhe funksionale duke i bere ato sa me te thjeshta, te efektshme dhe eficiente.
- Ka marredhenie ekuivalente e bashkepunimi me te gjitha Shefat e Departamenteve Shkencore dhe te sektoreve te tjere te ISHP-se, ndersa per problemet e sistemimit dhe te menaxhimit te personelit, te departamenteve dhe sektoreve, ato jane ne vartesi te Drejtorit te ISHP-se, i cili ja kalon per veprime te metejshme Pergjegjesit te Zyres se Burimeve Njerezore.
- Ka pergjegjesi direkte per mbajtjen e gjithe dokumentacionit:
 - Libreza pune
 - Kontrata pune
 - Rregjister themeltar i punonjesve
 - Dosje individuale per gjithe punonjesit e ISHP-se
- Pregatit projektin e organigrames, strukturat organizative duke u bazuar ne misioni e pergjithshem te ISHP-se.
- Merr pjese ne hartimin e politikës shendetesore ne ISHP, zberthen dhe ndjek zbatimin percaktuar nga kjo politike ne fushen e personelit, drejton, planifikon trajnimet dhe ndjek ecurine e punes se tyre.

- Merr pjese ne planifikimin e pregatitjes dhe trajnimit te punonjesve te rinj.
- Mbulon problemet e personelit te stafit te institutit ne pergjithesi, drejton dhe ndjek procedurat e perzgjedhjeve se kuadrit drejtues, kryen veprimet perkatese per levizjet transferimet emertimin e personelit perkates, masat administrative, etj.
- Pergatit dhe i paraqet Drejtorit te ISHP-se per miratim strukturat organizative dhe organikat e institucionit.
- Ne baze te kriterëve te percaktuara nga Qeveria, studion dhe i paraqet titullarit emertimet e specialisteve ne ISHP.
- Mban pergjegjesi per mbarevajtjen e te gjitha puneve brenda sektorit qe mbulon dhe duhet te njohi mire dhe tua beje te njohur rregullat e etikes punonjesve te tjere dhe ne menyre periodike te kontrolloje respektimin e tyre.
- Shqyrton ankesat per shkelje te etikes dhe merr masa per menjanimin e tyre.
- Kontrollon periodikisht zbatimin e rregullave te etikes ne pergjithesi.
- Merr masa për pajisjen e të gjithë punonjësve me kartën e identifikimit të institucionit dhe kontrollon e përgjigjet që të gjithë punonjësit të zbatojnë rregulloren e brendshme për hyrje-daljet dhe lëvizjet brenda institucionit.
- Me miratimin e Drejtorit përcakton rregullat e hyrje-daljes për punonjësit dhe vizitorët, oraret e pritjes dhe takime me subjekte të tjera dhe kontrollon respektimin e tyre.

8. DEPARTAMENTET SHKENCORE TË ISHP-se

ISHP është i organizuar ne 5 (pese) Departamente Shkencore:

- **DEPARTAMENTI I KONTROLLIT TE SEMUNDJEVE INFEKTIVE;**
- **DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISE DHE SISTEMEVE SHENDETESORE;**
- **DEPARTAMENTI I INFORMACIONIT SHENDETESOR, TEKNOLOGJISE DHE KOMUNIKIMIT;**
- **DEPARTAMENTI I SHENDETIT DHE MJEDISIT**
- **DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE PROMOCIONIT TE SHENDETIT.**

Secili Departament drejtohet nga Shefi i vet.

Secili Departament eshte i perbere nga Sektore, Seksione, Njesi, dhe, ne vartesi te specifikes se vet edhe nga Laboratore. Ne krye te Sektoreve jane shefat perkates; ne krye te Seksioneve, Njesive, Laboratoreve jane pergjegjesit perkates.

Organigrama e ISHP-se (shih me lart), jep, ndonese skematikisht, ne menyre te detajuar:

- **Strukturen perberese te tere ISHP-se,**
- **Strukturen perberese te secilit Departament Shkencor,**
- **Vartesite hierarqike dhe nderlidhjet organike dhe funksionale ndermjet tere pjeseve perberese te struktures.**

Ne fund te fundit, eshte pikerisht operimi adekuat i kesaj vartesie dhe kesaj nderlidhjeje organike dhe funksionale bazamenti per realizimin e tere veprimtarise se ISHP-se si qendra kombetare kerkimore/shkencore, e references dhe ekspertizes, e operativitetit ne terren, si dhe njeheresh trajnuese/universitare ne fushen e shendetit publik, cilesi kjo e fundit, qe dikton nderlidhjen organike

dhe funksionale ndermjet ISHP-se dhe Fakultetit te Mjekesise (Departamentit te tij te Shendetit Publik ne radhe te pare).

Ky kapitull i Rregullores se ISHP-se procedon me:

Se pari, paraqitjen e detyrave dhe te drejtave te Shefit te Departamentit Shkencor.

Se dyti, paraqitjen ne menyre te permbledhur por gjithepershires te funksioneve te secilit Departament Shkencor.

SHEFI I DEPARTAMENTIT SHKENCOR

Shefi i Departamentit Shkencor emerohet nga Drejtori i ISHP-se bazuar ne kriteret e miratuara nga Keshilli Shkencor dhe legjislacioni ne fuqi.

Kriteret për emërimin e Shefit te Departamentit Shkencor te ISHP-se jane ne perputhshmeri te plote me funksionet e ISHP-se te percaktuara ligjerisht: *“Instituti i Shendetit Publik eshte qender e kerkimit shkencor ne shendet publik, qender reference e sherbimeve ne fushen e shendetit publik, qender universitare e trajnimit ne shendet publik dhe qender e informacionit ne shendet publik”* (neni 12, Ligji “Per Shendetin Publik”, nr.10 138, datë 11.5.2009). Rrjedhimisht, kriteret per emerimin e Shefit te Departamentit Shkencor te ISHP-se jane:

- (i) Mjek,
- (ii) Specializim pasuniversitar ne fushen e Shendetit Publik,
- (iii) Te pakten Grada Shkencore “Doktor i Shkencave” (me perparesi prania e Titujve Shkencore “Profesor” apo/dhe “Profesor i asociuar”),
- (iv) Eksperience ne aktivitetin shkencor dhe akademik ne fushen e Shendetit Publik.

Detyrat/Funksionet e Shefit te Departamentit Shkencor:

- (i) Ështe pergjegjes per sigurimin e normalitetit te procesit administrativ dhe aktivitetit studimor e operativ te Departamentit perkates. Ai eshte epror i drejtperdrejte per punonjesit e Departamentit.

- (ii) Eshte pergjegjes per perpilimin dhe zbatimin e vizionit, misionit, strategjise dhe objektivave te Departamentit qe drejton.
- (iii) Drejton dhe kontrollon ne vazhdimesi zbatimin e detyrave te Departamentit konform planit strategjik-operacional afat-shkurter e afat-mesem te departamentit, te perpiluar nen drejtimin e tij ne baze te vizionit, misionit, strategjise dhe objektivave te Departamentit, dhe te miratuar nga Drejtori dhe Keshilli Shkencor i ISHP-se. Ai mund t' ia delegeje kompetencat e veta Shefave te Sektoreve, Seksioneve, Njesive, Laboratoreve, apo specialisteve te caktuar per plotesimin e detyrave funksionale.
- (iv) Vlereson planet e punes kerkimore-shkencore te Departamentit ne baze te planeve te paraqitura nga vartesit e tij ne perputhje me vizionin/misionin dhe strategjine/objektivat, duke bashkerenduar planifikimin e punes edhe ne bashkepunim me ate te Departamenteve/sektoreve te tjere te ISHP-se. Planet e punes i dorezohen Drejtorise se ISHP-se per miratim.
- (v) Siguron zbatimin ne kohe dhe me cilesi te planeve te punes ne Departament, duke siguruar kushtet objektive per realizimin e tyre.
- (vi) Mban lidhje te drejtperdrejta me Drejtorin e ISHP-se, merr prej tij urdhera dhe raportin ne te per zbatimin e tyre.
- (vii) Merr detyra nga Drejtori i ISHP-se dhe u a percakton e ndan ato per zbatim Sektoreve/Njesive perkatese te Departamentit.
- (viii) Pergjigjet per punen e vartesve te tij para Drejtorit te ISHP-se.
- (ix) Kujdeset per disiplinën e punes ne Departament dhe per mirembajtjene e bazes materiale ekzistuese.
- (x) Ai vete ose dhe ne bashkepunim me Pergjegjesin e Zyres se Burimeve Njerezore, i ben Drejtorit te ISHP-se propozime me shkrim per emerime apo zevendesime brenda per brenda Departamentit, per masa ndeshkimore deri shkarkim te punonjesve te Departamentit me argumentimet perkatese, si dhe per pjesemarrje te punonjesve te Departamentit ne aktivite brenda dhe jashte shtetit, gjithmone me argumentimet perkatese.
- (xi) Analizon ne vijuesmeri veprimtarine e Departamentit dhe sherbimit ne rrethe.
- (xii) Mban lidhje me te gjithe sektoret e sherbimit shendetesor, arsimor, shoqatat e ndryshme, organet dhe institucionet e medias.
- (xiii) Organizon dhe drejton veprimtarine per efektivitetin e edukimit te vazhdueshem profesional te punonjesve te Departamentit.

**Shefat e Sektoreve perberes te Departamentit,
Shefat/Pergjegjesit e Seksioneve perberes te Departamentit,
Shefat/Pergjegjesit e Laboratoreve perberes te Departamentit,
apo Pergjegjesit e Njesive perberese te Departamentit**

emerohen nga Shefi i Departamentit Shkencor perkates (me miratimin e Drejtorit te ISHP-se).

Kriteret për emërimin **Shefave te Sektoreve** jane ne perputhshmeri te plote me funksionet e ISHP-se te percaktuara ligjerisht: *“Instituti i Shendetit Publik eshte qender e kerkimit shkencor ne shendet publik, qender reference e sherbimeve ne fushen e shendetit publik, qender universitare e trajnimit ne shendet publik dhe qender e informacionit ne shendet publik”* (neni 12, Ligji “Per Shendetin Publik”, nr.10 138, datë 11.5.2009). Rrjedhimisht, kriteret per emerimin e Shefave te Sektoreve jane:

- (i) Mjek/Specialist i Shendetit Publik,
- (ii) Specializim pasuniversitar ne fushen perkatese (epidemiologji, mikrobiologji, etj)
- (iii) Te pakten Grada Shkencore “Doktor i Shkencave” (me perparesi prania e Titujve Shkencore “Profesor” apo/dhe “Profesor i asocijuar”),
- (iv) Eksperience ne aktivitetin shkencor dhe akademik ne fushen e Shendetit Publik.

**Shefat e Sektoreve perberes te Departamentit,
Shefat/Pergjegjesit e Seksioneve perberes te Departamentit,
Shefat/Pergjegjesit e Laboratoreve perberes te Departamentit,
apo Pergjegjesit e Njesive perberese te Departamentit**

kane per detyre te ndihmojne Shefin e Departamentit dhe te bashkepunojne ngushtesisht me te per realizimin ne kohe, ne sasine dhe cilesine e duhur te detyrave te Departamentit konform planeve te punes te miratuara nga Keshilli Shkencor dhe Drejtori i ISHP-se.

Detyrat/funksionet e tyre percaktohen ne detaje ne Rregulloren e Brendshme te Departamentit Shkencor perkates.

8.1. DEPARTAMENTI I KONTROLLIT TE SEMUNDJEVE INFEKTIVE

Departamenti i Kontrollit te Semundjeve Infektive eshte qendra kombetare koordinuese e operativitetit per kontrollin dhe parandalimin e semundjeve infektive dhe zbatimin e Rregullores Nderkombetare te Shendetit. Eshte njeheresh qendra kombetare e references, ekspertizes ne kete fushe. Organizon dhe zbaton kerkime dhe projekte kombetare dhe nderkombetare ne fushen e diagnozes dhe kontrollit te semundjeve infektive.

Departamenti i Kontrollit te Semundjeve Infektive e ushtron aktivitetin e vet ne drejtimet e mesiperme ne baze te planeve perkatese afat-shkurtera dhe afat-mesme te perpiluara prej tij dhe miratuara nga Drejtoria dhe Keshilli Shkencor i ISHP-se, konform zbatimit te ligjeve/akteve nenligjore/urdheresave perkatese te Ministrise se Shendetesise ne fushen e kontrollit dhe parandalimit te semundjeve infektive, perfshire ate te shendetit te nenes dhe femijes.

Departamenti i Kontrollit te Semundjeve Infektive e ushtron aktivitetin e vet ne bashkepunim te ngushte me Departamentet e tjera shkencore te ISHP-se dhe me Sherbimet Epidemiologjike (perfshire Labororet Mikrobiologjike te Shendetit Publik) te Rretheve.

Organigrama (Struktura perberese) e Departamentit te Kontrollit te Semundjeve Infektive eshte ne funksion te kaheve/drejtimeve baze te aktivitetit te tij:

- 1) **Spektori i Survejances Kombetare te Semundjeve Infektive** eshte Qendra Kombetare e koordinimit te survejances se semundjeve infektive, çka do te thote grumbullon, perpunon, analizon ne kohe dhe ne vijueshmeri te dhenat mbi semundshmerine infektive, te derguara ne ISHP (ne Departamentin e Kontrollit te Semundjeve Infektive) nga Sherbimet Epidemiologjike e te gjitha Rretheve te vendit dhe nderhyn apo vepron ne baze te ketyre te dhenave. Burimi i te dhenave

perfshin kujdesin paresor, spitalor dytesor dhe spitalor tretesor si ne sherbimin publik dhe ate privat. Po keshtu, ky sektor vlereson çdo ngjarje te pazakonte ne vend dhe, ne bashkepunim edhe me Departamentet e tjera te ISHP-se apo struktura te tjera, njofton menjehere Drejtorine e ISHP-se, Ministrine e Shendetesise dhe OBSH-ne dhe realizon te gjitha nderhyrjet ndaj shperthimeve epidemike apo ndodhive jo te zakonshme ne vend apo rajon, duke permbushur funksionet e tij si qender e koordinimit per Rregulloren Nderkombetare te Shendetit, (konform Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.772, date 24.9.2010 “Per zbatimin e Rregullores Nderkombetare te Shendetit”, ku ISHP percaktohet si Pika Kombetare Fokale e kesaj Regulloreje). Ky Sektor eshte Qendra Kombetare e Epidemiologjise te Semundjeve Infektive, duke sherbyer njeheresh edhe si bazamenti i Qendres se zhvillimit rajonal per koordinimin e survejances dhe kontrollit te semundjeve infektive per vendet e Europes Juglindore (Shqiperi, Mal i Zi, Maqedoni, Kroaci, Serbi, Rumani, Bullgari, Bosnje dhe Hercegovine, Moldavi, Kosove).

- 2) **Spektori i Programit Kombetar te Vaksinit** eshte struktura pergjegjese ne shkalle vendi per menaxhimin e programit te vaksinit duke kryer (i) sigurimin ne kohe dhe sasine e duhur e te gjitha vaksineve (antigeneve) te Kalendarit Kombetar te Vaksinit dhe shperndarjen periodike (çdo tremujor) te tyre ne tere rrethet e vendit; (ii) monitorimin e ecurise se programit kombetar te vaksinit; (iii) monitorimin e niveleve te mbuleses vaksinore per secilin antigen te Kalendarit Kombetar te Vaksinit; (iv) sigurimin e zinxhirit ftohes dhe monitorimin e performances se tij; (v) organizimin/zhvillimin e fushatave te vaksinit per te siguruar mbulesa te larte vaksinore ne çdo komunitet; (vi) nxitjen per perdorimin e teknologjise se informacionit apo menyra te tjera per te siguruar nje nivel mbrojtjeje vaksinore ne kohe dhe te larte ne sherbim te qytetareve; (vii) monitorimin e reaksioneve pasvaksinore (efekteve anesore te padeshirueshme te vaksines/vaksinit) ne bashkepunim me Sektorin e Survejances Kombetare te Semundjeve Infektive te ketij Departamenti (ISHP) dhe Qendren Kombetare te Kontrollit te Barnave.

Ky sektor monitoron punen e sektoreve perkates ne DSHP-te ne rrethe apo ne sektore te tjere publike dhe private qe lidhen me vaksinin. Ai kryen nderhyrje, qe permiresojne programin e vaksinit dhe efektivitetin e tij.

- 3) **Sektori i Programit Kombetare te HIV/AIDS** eshte struktura pergjegjese ne shkalle vendi (i) e survejances se gjenerates se pare (dikur) dhe gjenerates se dyte (aktualisht) te HIV/AIDS, (ii) e kryerjes periodikisht te studimeve perkatese epidemiologjike te tipit YRBS (Youth Risky Behaviour Survey) dhe Bio-BSS (Biological and Behavioural Surveillance Survey) te bazuara njeheresh ne-grupet-ne-risk-te-larte dhe ne popullaten e pergjithshme, (iii) e epidemiologjise se HIV/AIDS dhe monitorimit te rasteve HIV/AIDS. Ky program ka per detyre te pergatise apo vleresoje raporte dhe programe kombetare dhe marre pjese ne ato nderkombetare per HIV/AIDS. Ai vlereson te gjitha nderhyrjet qe kryhen ne fushen e HIV/AIDS ne vend dhe nxit nderhyrje te reja e efikase.
- 4) **Sektori i Kontrollit te Vektoreve** eshte struktura pergjegjese per studimet ne entomologjine mjekesore dhe rodentologjine mjekesore, objektivi kryesor i te cilave eshte (i) perftimi ne dinamike i hartave te biocenzave-biotopeve-habitateve te vektoreve, (ii) identifikimi taksonomik i vektoreve, (iii) percaktimi i pranise dhe nivelit te rezistences se insekteve-vektore ndaj insekticideve (insektido-rezistenca) dhe brejtesve-rezervuare ndaj raticideve (raticido-rezistenca).
- 5) **Sektori i Kontrollit te Infeksioneve Spitalore** eshte struktura pergjegjese per studimet dhe monitorimin e infeksioneve nozokomiale ne sherbimin spitalor ne te gjitha vendin. Komponente organike te objektivit te mesiperem jane aspektet e dezinfektimit (efikasiteti/efektiviteti i dezinfektanteve dhe metodave/teknikave te dezinfektimit) dhe antibiotikorezistences.
- 6) **Sektori i Laboratoreve Referente Kombetare te Mikrobiologjise ne Shendetin Publik** eshte, sikurse e tregon emertimi, struktura e references dhe ekspertizes ne diagnostiken mikrobiologjike ne fushen e shendetit publik ne Shqiperi. Objektivat kryesore te aktivitetit te Laboratoreve perberes te ketij Sektori, konkretisht:
- **Labororet e Virologjise,**
 - **Labororet e Bakteriologjise,**
 - **Labororet e Parazitologjise,**
 - **Laboratori i Mykologjise,**
 - **Laboratori i HIV/AIDS dhe Hepatiteve Virale,**
 - **Laboratori i Mikrobiologjise molekulare,**

konsistojne ne (i) zhvillimin dhe perditesimin ne sasi dhe cilesi te diagnostikes laboratorike dhe realizimin e kerkesave perkatese te Organizates Boterore te Shendetesise (Rajoni European) lidhur me çertifikimin periodik te tyre prej asaj Organizate, apo organizmavet te tjere nderkombetare (ii) kryerjen e ekspertizes diagnostike ne shkalle vendi, (iii) ndihmesen ne etiologjine e shperthimeve epidemike, studimet e mirefillta mikrobiologjike, (iv) studimet epidemiologjike/sero-epidemiologjike ne bashkepunim te ngushte me Sektoret e tjere perberes te ketij Departamenti dhe me Departamentet e tjere te ISHP-se. Si dhe sigurimin e biosigurise ne ISHP dhe ne te gjithe vendin.

7) **Spektori i Prodhimit te Antigeneve dhe Serumeve Diagnostike dhe**

Preparatorise perfshin prodhimin e antigeneve dhe serumeve diagnostike, si dhe pergatitjen e terreneve te ndryshme kryesisht per diagnozen bakteriologjike. Ai monitoron dhe siguron cilesine e diagnozes bakteriologjike ne te gjithe laboratoret mikrobiologjike te shendetit publik te vendit nepermjet vleresimeve te cilesise dhe monitorimit te standardeve dhe protokolleve te miratuara.

Drejtimit kryesore te aktivitetit te Departamentit te Kontrollit te Semundjeve Infektive jane:

- (i) Koordinimi i Sistemit te Integruar te Survejances te Semundjeve Infektive (SISSI) ne Shqiperi:
 - Sistemi Madhor i Survejances te Bazuar-ne-Semundjes;
 - Sistemi i Survejances ALERT (te Bazuar-ne-Sindroma);
 - Sistemet e tjera perberese, te Bazuar-ne-Rast dhe me Konfirmim Laboratorik, te shenjuar per nozologji infeksioze specifike: Poliomieliti/Paralizat Flakside Akute, Fruthi dhe Rubeola, Sindromi i Rubeoles Kongjenitale, Gripi, Infeksionet Seksualisht te Transmetueshme, Hepatitet Virale, Infeksionet invazive nga *Haemophilus influenzae b*, Meningitet, Rotaviruset, etj.
- (ii) Zbulimi i hershem dhe koordinimi i pergjigjes se shpejte ndaj shperthimeve epidemike.
Monitorimi i hasje se shperthimeve epidemike.
- (iii) Studimet epidemiologjike ne fushen e semundjeve infektive per percaktimin e trendit te tyre sipas triades klasike person-vend-kohe dhe identifikimin e faktoreve risk te hasjes se tyre.

- (iv) Menaxhimi i programit të vaksinimit duke përfshirë këtu të gjitha aspektet e tij, si monitorimi i niveleve të mbulesës vaksinore në kohë e hapësirë, futja e vaksinave të reja, adaptimi i kalendarit të vaksinimit, menaxhimi i zinxhirit të ftohtë, survejanca e reaksioneve pasvaksinore, përgatitja e strategjive kombëtare të vaksinimit, koordinimi i regjistrimit elektronik të vaksinimit, etj.
- (v) Menaxhimi i programit të luftës kundër HIV/AIDS dhe IST-ve duke përfshirë këtu të gjitha aspektet, si ndjekja dhe identifikimi i rasteve, survejanca e integruar e HIV/AIDS, koordinimi i survejancës sindromike dhe laboratorike për IST-te, përgatitja e strategjive kombëtare, koordinimi i programeve specifike përfshirë edhe ato të edukimit për HIV/AIDS, etj.
- (vi) Menaxhimi i programit të kontrollit të vektoreve duke kryer identifikimin dhe shpërndarjen e vektoreve kryesore në vend, identifikimin e faktorëve të riskut, studime epidemiologjike dhe ekologjike për vektorët, koordinimin e udhëzimeve dhe trajnimit për kuften kundër vektoreve.
Studime mbi habitatet/biotopet/biocenozat e vektoreve (insekte, minj) të sëmundjeve infektive me transmetim vektorial; studime mbi insekticido- dhe raticidorezistencën dhe masat e kontrollit të tyre.
- (vii) Studime sero-epidemiologjike mbi profilet e mbrojtjes specifike pasvaksinore të popullatës ndaj sëmundjeve infektive të parandalueshme-me-vaksinim dhe mbi profilet imunologjike të popullatës ndaj sëmundjeve të tjera infektive.
- (viii) Realizimi i diagnozës laboratorike për sëmundjet infektive me rrezikshmeri të lartë, ato që transmetohen nga vektorët dhe zoonozat.
- (ix) Përgatitja dhe koordinimi i strategjive dhe programeve për kontrollin dhe parandalimin e zoonozave të kontrollit dhe parandalimit veterinar (bruceloza, antraksi, leptospirozat, listerioza, etj) në bashkëpunim të ngushtë me shërbimin veterinar (Institutin e Kerkimeve Veterinare).
- (x) Përpilimi i sistemeve të reja sëmundje-specifike përberese të SISSI, dhe koordinimi për zbatimin e tyre në praktikë.
- (xi) Përpilimi i udhëzimeve dhe koordinimi në fushën e diagnozës mikrobiologjike të sëmundjeve infektive.
- (xii) Studime në fushën e diagnozës mikrobiologjike të sëmundjeve infektive
- (xiii) Rritja e games dhe cilësisë së diagnozës mikrobiologjike në drejtim të konfirmimit laboratorik të rastit nëpërmjet aplikimit të teknikave të biologjisë molekulare, etj.

- (xiv) Ruajtja dhe pasurimi i bankes se linjave qelizore qe sherbejne per diagnozen virologjike.
- (xv) Sigurimi i biosigurise ne labororet e ISHP-se dhe koordinimi i punes ne kete drejtim per te gjitha vendin.
- (xvi) Qendra koordinuese kombetare per aplikimin ne vend te Rregullores Nderkombetare te Shendetit: pergatitja e strategjive perkatese dhe koordinimi ndermjet aktoreve brenda ISHP-se si dhe ndermjet ISHP-se me sektoret e tjere brenda dhe jashta sferes se shendetesise per zbulimin e hershem dhe pergjigjen ndaj eventualisht ndodhive shendetesore jo te zakonshme te shendetit publik ne Shqiperi.
- (xvii) Qendra e zhvillimit rajonal per koordinimin e survejances dhe kontrollit te semundjeve infektive per vendet e Europes Juglindore (Shqiperi, Mal i Zi, Maqedoni, Kroaci, Serbi, Rumani, Bullgari, Bosnje dhe Hercegovine, Moldavi, Kosove), e cila synon te rrise bashkepunimin per zbulimin e hershem dhe pergjigjen e shpejte ndaj eventualisht ndodhive shendetesore jo te zakonshme te shendetit publik per vendet nderkufitare.
- (xviii) Planizimi/organizimi/drejtimi teknik i seminareve, workshopeve, mbledhjeve teknike me punonjesit e shendetit publik te rretheve.
- (xix) Pergatitja e udhezueseve/manualeve teknike per punonjesit e shendetit publik te rretheve.

8.2 DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISE DHE SISTEMEVE SHENDETESORE

Departamenti i Epidemiologjise dhe Sistemeve Shendetesore eshte qendra kombetare ne fushen e shendetit publik per prodhimin e indikatoreve shendetesore, kontrollin dhe parandalimin e semundjeve kronike jo-infektive, epidemiologjine e shendetit riprodhues, studimin/kerkimin mbi sistemet shendetesore, studimin dhe monitorimin e problematikes se droges ne Shqiperi. Ai ka per funksion te kryeje kerkime kualitative dhe kuantitative ne ndihme te politikave dhe strategjive te shendetit, te monitoroje dhe vleresoje impaktin e nderhyrjeve ne fushen e shendetit publik, te nxise/mbeshtese koordinimin nder-institucional, dhe te kontribuojne ne forcimin e kapaciteteve ne fushat e menaxhimit, planifikimit dhe ekonomise shendetesore, me synim mbrojtjen e shendetit te popullates dhe rritjes se cilesise se sherbimeve ne shendetesi.

Organigrama (Struktura perberese) e Departamentit te Epidemiologjise dhe Sistemeve Shendetesore eshte ne funksion te kaheve/drejtimeve baze te aktivitetit te tij:

- 1) **Spektori “Observatori Kombetar Epidemiologjik”** (konform nenit 40 te Ligjit nr.10 138 “Për Shëndetin Publik, datë 11.5.2009) eshte struktura pergjegjese per prodhimin periodik te indikatoreve shendetesore bazuar ne te dhenat qe merren periodikisht nga INSTAT (te dhenat demografike, te dhenat mbi vdekshmerine, lindshmerine, etj), nga Ministria e Shendetesise (te dhenat mbi semundshmerine spitalore, menaxhimin spitalor, etj), nga Instituti i Sigurimeve dhe Kujdesit Shendetesor (te dhenat mbi semundshmerine ambulator, menaxhimin e kujdesit shendetesor paresor, etj), nga Departamenti i Kontrollit te Semundjeve Infektive i ISHP-se (te dhenat e grumbulluara dhe analizuara nga ai Departament mbi semundshmerine infektive), nga Departamenti i Mjedisit dhe Shendetit te ISHP-se (te dhenat e grumbulluara dhe analizuara nga ai Departament mbi monitorimin e ujit te pijshem, monitorimin e determinanteve te tjere risk mjedisore), si dhe dhe burime te tjera brenda e jashta fushes se shendetesise.

- 2) **Sektori i Epidemiologjise te Semundjeve Kronike Jo-Infektive dhe Kerkimit mbi Politikat Shendetesore** eshte struktura pergjegjese e studimit mbi kontrollin e semundjeve kronike jo-infektive, bazuar ne survejancen dhe studimin epidemiologjik, me fokus te veçante ne identifikimin dhe monitorimin e faktoreve/determinanteve risk. Mbi bazen e te dhenave te perftuara mbi studimin mbi shkaktesine dhe rrjedhojat perkatese, si dhe te dhenat e lartpermendura mbi semundshmerine dhe vdekshmerine te grumbulluara nga Observatori Kombetar Epidemiologjik, ai realizon kerkimin mbi politikat shendetesore ne vendin tone ne fushen e semundjeve kronike (semundjet kardio-cerebro-vaskulare, kanceri, diabeti, semundjet pulmonare kronike, etj).
- 3) **Sektori i Kerkimit ne Popullate** eshte struktura pergjegjese e studimit te aspekteve te ndryshme te **Epidemiologjise se Shendetit Riprodhues**, te tilla si (i) Shendetit i Nenes dhe Femijes (semundshmeria dhe vdekshmeria foshnjore, femijenore <5 vjeç, ametare), (ii) Survejanca e Abortit, (iii) Survejanca e Defekteve te Lindura, (iv) Planifikimi Familjar (Programi LMIS mbi kontracetivet), (v) Shendetit i Gruas: moshat riprodhuese, menopauza, pas-menopauza, si dhe aspekteve te **Epidemiologjise se Shendetit Mendor**.
- 4) **Qendra Kombetare e Informacionit per Drogat** eshte struktura pergjegjese qe merret me grumbullimin periodik te te dhenave per drogen (i) nga burimet e ndryshme te kerkeses per droge, dhe (ii) burimet e ndryshme te ofertes per droge. Mbi bazen e te dhenave te grumbulluara nga kjo Qender, Grupi Kombetar i Eksperteve per Drogen realizon prodhimin e indikatorëve epidemiologjike te reduktimit te kerkeses per droge dhe atyre te reduktimit te ofertes, qe perbejne bazamentin e Raportit Kombetar Vjetor te Drogës te perpiluar nga ai Grup konform udhezimeve dhe kerkesave standarde perkatese te EMCDDA (European Center of Drugs and Drug Addiction – Qendra Europiane e Drogës dhe Droge-Vartesise).

Departamenti i Epidemiologjise dhe Sistemeve Shendetesore e ushtron aktivitetin e vet ne drejtimet e mesiperme ne mbeshtetje dhe funksion te ISHP-se dhe Ministrise se Shendetesise, ne baze te planeve perkatese afat-shkurtera dhe afat-mesme te perpiluara prej tij dhe miratuara nga Drejtoria dhe Keshilli Shkencor i ISHP-se, konform zbatimit te ligjeve/akteve nenligjore/urdheresave perkatese te Ministrise se

Shendetesise ne fushen e kontrollit dhe parandalimit te semundjeve kronike jo-infektive, perfshire ate te shendetit te nenes dhe femijes.

Departamenti i Epidemiologjise dhe Sistemeve Shendetesore e ushtron aktivitetin e vet ne bashkepunim te ngushte me Departamentet e tjera shkencore te ISHP-se, Qendren Spitalore Universitare “Nene Tereza”, Drejtorite/Sherbimet e Shendetit Publik ne baze Rajoni/Rrethi, si dhe Sektore Publike jashta sferes se shendetesise dhe/ose organizma/organizata te ndryshme jo-publike brenda dhe jashte vendit.

Drejtimet kryesore te aktivitetit te Departamentit te Epidemiologjise dhe Sistemeve Shendetesore jane:

- 1) Prodhimi periodik i indikatoreve te ndryshem shendetesore (Observatori Kombetar Epidemiologjik), konkretisht:
 - (i) Indikatoret Demografike dhe Shtesa natyrore e popullise dhe piramida e popullates.
 - (ii) Indikoret (=Nivelet) e Vdekshmerise se Pergjithshme (=nga te gjitha shkaqet) Krude dhe te Standardizuar ne popullaten totale (=te dy gjinite, te gjitha grup-moshat), sipas gjinise (=gjini-specifike), sipas moshes (=moshe-specifike), sipas gjinise dhe moshes (gjini-specifike dhe moshe-specifike).
 - (iii) Indikoret (=Nivelet) e Vdekshmerise Krude dhe te Standardizuar sipas Shkaqeve (=Shkak-specifike) ne popullaten totale (=vdekshmeria shkak-specifike per te dy gjinite dhe te gjitha grup-moshat), popullaten totale sipas gjinise (=vdekshmeria gjini-specifike, shkak-specifike), popullaten totale sipas grup-moshave (=vdekshmeria moshe-specifike, shkak-specifike), popullaten totale sipas gjinise dhe grup-moshave (=vdekshmeria gjini-specifike, moshe-specifike, shkak-specifike).
 - (iv) Indikoret (=Nivelet) e Vdekshmerise Amesore.
 - (v) Indikoret e Vdekshmerise Fetale: Nivelet e Vdekshmerise Fetale; Raporti i Vdekshmerise Fetale.
 - (vi) Indikoret e Vdekshmerise Perinatale: Nivelet e Vdekshmerise Perinatale; Raporti i Vdekshmerise Perinatale.
 - (vii) Indikoret (=Nivelet) e Vdekshmerise Foshnjore (0-1 vjeç) per grup-moshen ne total, si dhe sipas 3 ndarjeve moshore ne muaj (Nivelet e Vdekshmerise

Neonatale te Hershme; Nivelet e Vdekshmerise Neonatale te Voneshme; Nivelet e Vdekshmerise Pas-neonatale).

- (viii) Indikatoret (=Nivelet) e Semundshmerise te-Bazuar-ne-Spital (Spitalore) Krude dhe te Standardizuar ne popullaten totale (=te dy gjinite, te gjitha grup-moshat), sipas gjinise (=gjini-specifike), sipas moshes (=moshe-specifike), sipas gjinise dhe moshes (gjini-specifike dhe moshe-specifike).
- (ix) Indikatoret (=Nivelet) e Semundshmerise te-Bazuar-ne-Spital (Spitalore) Krude dhe te Standardizuar sipas Shkaqeve (=Shkak-specifike) ne popullaten totale (=vdekshmeria shkak-specifike per te dy gjinite dhe te gjitha grup-moshat), popullaten totale sipas gjinise (=vdekshmeria gjini-specifike, shkak-specifike), popullaten totale sipas grup-moshave (=vdekshmeria moshe-specifike, shkak-specifike), popullaten totale sipas gjinise dhe grup-moshave (=vdekshmeria gjini-specifike, moshe-specifike, shkak-specifike).
- (x) Indikatoret (=Nivelet) e Semundshmerise te-Bazuar-ne-Sherbimin Paresor Krude dhe te Standardizuar ne popullaten totale (=te dy gjinite, te gjitha grup-moshat), sipas gjinise (=gjini-specifike), sipas moshes (=moshe-specifike), sipas gjinise dhe moshes (gjini-specifike dhe moshe-specifike).
- (xi) Indikatoret (=Nivelet) e Semundshmerise te-Bazuar-ne-Sherbimin Paresor Krude dhe te Standardizuar sipas Shkaqeve (=Shkak-specifike) ne popullaten totale (=vdekshmeria shkak-specifike per te dy gjinite dhe te gjitha grup-moshat), popullaten totale sipas gjinise (=vdekshmeria gjini-specifike, shkak-specifike), popullaten totale sipas grup-moshave (=vdekshmeria moshe-specifike, shkak-specifike), popullaten totale sipas gjinise dhe grup-moshave (=vdekshmeria gjini-specifike, moshe-specifike, shkak-specifike).
- (xii) Indikoret e Rritjes se Popullates dhe Lindjes se Gjalle: Nivelet e Rritjes se Popullates; Nivelet e Fertilitetit te Pergjithshem; Nivelet e Shtatzenise se Pergjithshme; Nivelet Moshe-Specifike te Fertilitetit; Nivelet e Fertilitetit Total.
- (xiii) Indikoret e Nderprerjes se Induktuar te Shtatzenise (=Aborteve): Nivelet e Nderprerjes se Induktuar te Shtatzenise; Raporti I i Nderprerjes se Induktuar te Shtatzenise; Raporti II i Nderprerjes se Induktuar te Shtatzenise.
- (xiv) Indikoret e Sherbimit dhe Menaxhimit Spitalor.
- (xv) Indikoret e Sherbimit/Kujdesit Shendetesor Paresor.
- (xvi) Indikoret e Aksesit ne Sherbimet Shendetesore (Paresor, Spitalor).

2) Studime mbi Epidemiologjine dhe Kontrollin e Semundjeve Kronike dhe mbi Politikat Shendetesore perkatese (Sektori i Semundjeve Kronike Jo-Infektive dhe Kerkimit mbi Politikat Shendetesore), konkretisht:

- (xvii) Studime ne popullate mbi faktoret risk te semundjeve kronike (perparesi semundjet kario-cerebro-vaskulare, kanceri, diabeti, semundjet pulmonare kronike).
- (xviii) Analiza epidemiologjike mbi shperndarjen dhe frekuencen e hasjes konform triades klasike epidemiologjike person-vend-kohe te semundjeve kronike.
- (xix) Studime mbi kapacitetet, nevojat dhe nivelet e performances profesionale te sherbimeve shendetesore ne fushen e semundjeve kronike.
- (xx) Analiza mbi nivelet e aksesit te popullates ne sherbimet shendetesore ne fushen e semundjeve kronike.
- (xxi) Ndertim dhe menaxhim i sistemeve te survejances specifike te semundjeve te ndryshme kronike (perparesi semundjet kario-cerebro-vaskulare, kanceri, diabeti, semundjet pulmonare kronike) dhe sherbimeve perkatese te kontrollit.
- (xxii) Monitorim dhe vleresim i strategjive/politikave te kontrollit per semundjet kronike.
- (xxiii) Pergatitje e materialeve trajnuese/instruktuese ne fushen e parandalimit paresor (edukim dhe promocion shendetesor), parandalimit dytesor (kapja e harshme e rasteve nepermjet depistimit), dhe parandalimit tretesor (cilesia e kujdesit perkates mjekesor ne drejtim te trajtimit adekuat) per semundjet kronike.
Pergatitje e udhezueseve/manualeve teknike per punonjesit e shendetit publik te rretheve.
- (xxiv) Pilotim modelesh te kontrollit te semundjeve kronike ne nivel qendror dhe nivel lokal, bazuar ne praktikat me te mira.
- (xxv) Mbeshtetje/koordinim lidhur me politikat dhe strategjite e reja ne fushen e kontrollit te semundjeve kronike nepermjet organizimit te seminareve, workshopeve, konferencave shkencore.

3) Studime ne fushen e Epidemiologjise se Shendetit Riprodhues dhe Epidemiologjise se Shendetit Mendor (Sektori i Kerkimit ne Popullate), konkretisht:

- (xxvi) Qendra Kombetare e Sistemit te Survejances se Abortit ne Shqiperi: grumbullimi nga te gjitha burimet perkatese i te dhenave mbi abortet, analiza

periodike e tyre, monitorimi (nepermjet operativitetit ne terren) i ecurise se sistemit teurvejances (identifikimi dhe eliminimi i bias-eve eventualisht te pranishem), perpilimi i raporteve shkencore, perditeseimi i aspekteve te ndryshem te objektivave perberese te strategjise perkatese.

(xxvii) Qendra Kombetare e Sistemit te Survejances se Defekteve te Lindura ne Shqiperi: grumbullimi nga te gjitha burimet perkatese i te dhenave mbi defektet e lindura (keqformimet kongjenitale), analiza periodike e tyre, monitorimi (nepermjet operativitetit ne terren) i ecurise se sistemit teurvejances (identifikimi dhe eliminimi i bias-eve eventualisht te pranishem), perpilimi i raporteve shkencore, perditeseimi i aspekteve te ndryshem te objektivave perberese te strategjise perkatese.

(xxviii) Programi Kombetar LMIS mbi kontracetivet: planifikimi ne baze te nevojave te te gjitha Rretheve te vendit ne sasi dhe sipas asortimenteve, shperndarja, dhe monitorimi mbi perdorimin e tyre.

(xxix) Studime epidemiologjike mbi aspekte te ndryshme te Planifikimit Familjar ne Shqiperi.

(xxx) Studime epidemiologjike mbi Semundshmerine dhe Vdekshmerine Foshnjore (0-1 vjeç) ne Shqiperi.

(xxxi) Studime epidemiologjike mbi semundshmerine dhe vdekshmerine femijenore (1-4 vjeç) ne Shqiperi.

(xxxii) Studime epidemiologjike mbi semundshmerine dhe vdekshmerine amesore ne Shqiperi.

(xxxiii) Studime epidemiologjike mbi Shendetin Mendor ne Shqiperi.

4) Qendra Kombetare e Informacionit per Drogat:

(xxxiv) Grumbullimi periodik i informacionit per drogat nga te gjitha burimet ekzistuese lidhur me kerkesen per droge dhe oferten per droge.

(xxxv) Pergatitja nga Grupi Kombetar i Eksperteve i Raporteve periodike Kombetare mbi situaten e droges (perdorimi, droge-vartesia, shperndarja/trafikimi) ne Shqiperi, konform udhezimeve dhe kerkesave standarde perkatese te EMCDDA (European Center of Drugs and Drug Addiction – Qendra Europiane e Droges dhe Droge-Vartesise).

8.3 DEPARTAMENTI I INFORMACIONIT SHENDETESOR, TEKNOLOGJISE DHE KOMUNIKIMIT

Departamenti i Informacionit Shendetesor, Teknologjise dhe Komunikimit ka si mision grumbullimin, unifikimin dhe analizën e të gjitha të dhënave dhe informacionit shëndetësor, përdorimin dhe diseminimin e strategjive efektive dhe bashkëkohore të komunikimit dhe informimit shëndetësor me qëllimin final përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor, e reflektuar kjo në rritje dhe përmirësim të qëndrueshëm të rezultateve dhe tregueseve shëndetësorë të popullatës së vendit. Është pikërisht ky Departament, ku përmbahet nga ana organike dhe funksionale “Magazina e të Dhenave” [“*Data Warehouse*”] e Sistemit të Informacionit Shendetesor të Shqipërisë.

Organigrama (Struktura perberese) e Departamentit të Informacionit Shendetesor, Teknologjise dhe Komunikimit është në funksion të kaheve/drejtimeve baze të aktivitetit të tij:

- 1) **Spektori i Biostatistikës dhe Teknologjise së Informacionit Shendetesor** përfaqëson qendrën kombëtare të grumbullimit të informacionit shëndetësor, si dhe të studimit, kërkimit, ekspertizës dhe trajnimit në fushën e administrimit dhe menaxhimit të informacionit shëndetësor (“**Magazina e të Dhenave**” [“*Data Warehouse*”]). Në bashkëpunim të ngushtë me Observatorin Kombëtar Epidemiologjik (Departamenti i Epidemiologjise dhe Sistemeve Shendetesore) si dhe me Departamentet e tjera të ISHP-se, ky Sektor, konkretisht njësia e tij e **Biostatistikës**, kryen analizën statistikore të të dhënave të ndryshme të informacionit shendetesor.
- 2) **Spektori i Botimeve dhe Komunikimit Shendetesor** përfaqëson qendrën kombëtare të informimit dhe komunikimit të informacionit shëndetësor në të gjitha nivelet, përfshirë politikë-bërësit dhe vendim-marrësit, ekspertët dhe profesionistët e sektorit shëndetësor, shoqërinë civile dhe publikun në tërësi. Ai përfaqëson po ashtu qendrën kombëtare në fushën e shendetit publik të raportimit

shkencor të situatës dhe treguesve shëndetësorë në popullatën e vendit përmes publikimeve periodike shkencore.

- 3) **Njesia e Mbeshtetjes se Edukimit ne Vazhdim ne Shendet Publik** perfaqeson strukturen e ISHP-se ne mbeshtetje ndaj Qendres Kombetare te Edukimit ne Vazhdim (QKEV) lidhur me edukimin ne vazhdim ne fushen e shendetit publik.
- 4) **Njesia e Mbeshtetjes se Kerkimit dhe Partnershipit ne Shendet Publik** luan rolin mbeshtetes per Drejtorine e ISHP-se lidhur me perpilimin e dokumentacionit perkates ne projekte studimore te bashkepunimit dhe partnershipit te ISHP me institucione te ndryshme brenda dhe jashta vendit ne fushen e shendetit publik.

Departamenti i Informacionit Shendetesor, Teknologjise dhe Komunikimit e ushtron aktivitetin e vet ne drejtimet e mesiperme ne mbeshtetje dhe funksion te ISHP-se dhe Ministrise se Shendetesise, ne baze te planeve perkatese afat-shkurtera dhe afat-mesme te perpiluara prej tij dhe miratuara nga Drejtoria dhe Keshilli Shkencor i ISHP-se.

Departamenti i Informacionit Shendetesor, Teknologjise dhe Komunikimit e ushtron aktivitetin e vet ne bashkepunim te ngushte me Departamentet e tjera shkencore te ISHP-se, Qendren Spitalore Universitare “Nene Tereza”, Drejtorite/Sherbimet e Shendetit Publik ne baze Rajoni/Rrethi, si dhe Sektore Publike jashta sferes se shendetesise dhe/ose organizma/organizata te ndryshme jo-publike brenda dhe jashte vendit.

Drejtimet kryesore te aktivitetit te Departamentit te Informacionit Shendetesor, Teknologjise dhe Komunikimit jane:

- (i) Grumbullimi periodik i informacionit shendetesor mbi semundshmerine spitalore nga baza e te dhenave (database) e Ministrise se Shendetesise.
Kontroli mbi sasine dhe cilesine e informacionit te grumbulluar.
Analiza statistikore e te dhenave te informacionit te grumbulluar.
- (ii) Grumbullimi periodik i informacionit shendetesor mbi aspektet e ndryshme te aktivitetit spitalor nga baza e te dhenave (database) e Ministrise se Shendetesise.
Kontroli mbi sasine dhe cilesine e informacionit te grumbulluar.
Analiza statistikore e te dhenave te informacionit te grumbulluar.

- (iii) Grumbullimi periodik i informacionit shendetesor qe permbahet ne Pasqyrat e tjera SH (pervec atyre te lidhura me semundjet infektive) nga baza e te dhenave (database) e Ministrise se Shendetesise.

Kontrrolli mbi sasine dhe cilesine e informacionit te grumbulluar.

Analiza statistikore e te dhenave te informacionit te grumbulluar.

- (iv) Grumbullimi periodik i informacionit shendetesor qe permbahet ne bazen e te dhenave (database) te Institutit te Sigurimeve dhe Kujdesit Shendetesor (ISKSH) lidhur me

- semundshmerine ne sherbimin e kujdesit shendetesor paresor;
- aspektet e ndryshme te aktivitetit dhe performances profesionale te sherbimeve te kujdesit shendetesor paresor.

Kontrrolli mbi sasine dhe cilesine e informacionit te grumbulluar.

Analiza statistikore e te dhenave te informacionit te grumbulluar.

- (v) Studime/kerkime në fushën e administrimit dhe menaxhimit të informacionit shëndetësor me synim optimalizimin e tregueseve perkates.

- (vi) Ekspertize dhe trajnime ne fushen e administrimit dhe menaxhimit te informacionit shendetesor me personelin shendetesor perkates ne baze rajoni dhe/ose rrethi ne tere vendin.

- (vii) Monitorimi dhe mbeshtetja teknike mbi operativitetin funksional te rrjetit te brendshem kompjuterik te ISHP-se dhe nderkembimin e informacionit ndermjet strukturave perberese te ISHP-se.

- (viii) Monitorimi dhe perditeseimi i *website* te ISHP-se lidhur me informacionet e prodhuara periodikisht nga Departamentet shkencore te ISHP-se.

- (ix) Informimi dhe komunikimi i informacionit shendetesor ne te gjitha nivelet, perfshire politike-beresit dhe vendim-marresit, ekspertet dhe profesionistet e sektorit shendetesor, shoqerine civile dhe publikun ne teresi.

- (x) Prodhimi periodik i **“Buletini Shkencor i Institutit te Shendetit Publik”**, qe perfaqeson kanalin kryesor te komunikimit dhe diseminimit te informacionit shendetesor tek profesionistet e shendetesisë dhe te gjithe aktorët dhe faktorët e sektorit te sherbimeve shendetesore ne nivel lokal dhe kombetar, perfshire edhe agjencite, organizmat dhe institucionet nderkombetare qe asistojne dhe mbeshtesin zhvillimin dhe persosjen e sistemit te sherbimeve shendetesore ne Shqipëri.

- (xi) Prodhimi periodik i **“Revista Mjekesore”** (ne shqip) dhe **“Albanian Medical Journal”** (homologu ne anglisht) përfaqëson mediumin e shkruar shkencor më të rëndësishëm (krahas njehersh me Buletinin e Shkencave Mjekesore te Fakultetit te Mjekesise, Universiteti i Tiranes) në fushën e shëndetësisë në vendin tonë. Kjo revistë përfaqëson kanalin kryesor të komunikimit të rezultateve të projekteve kërkimore-shkencore në fushën e shëndetësisë në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.
- (xii) Prodhimi periodik i **materialeve të tjera informuese**: shoqëria civile dhe opinionin publik në tërësi informohen rreth aktiviteteve dhe indikatorëve kryesorë të shëndetit të popullatës përmes kanaleve të tjera alternative të komunikimit të tilla si postera, fletë-palosje, apo komunikata për shtyp.
- (xiii) Mbeshtetje ndaj Qendres Kombetare te Edukimit ne Vazhdim (QKEV) lidhur me edukimin ne vazhdim ne fushen e shendetit publik.
- (xiv) Mbeshtetje per Drejtorine e ISHP-se lidhur me perpilimin e dokumentacionit perkates ne projekte studimore te bashkepunimit dhe partnershipit te ISHP me institucione te ndryshme brenda dhe jashta vendit ne fushen e shendetit publik.

8.4 DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE PROMOCIONIT SHENDETESOR

Departamenti i Edukimit dhe Promocionit Shendetesor ka si mision grumbullimin, unifikimin dhe analizën e të gjitha të dhënave dhe informacionit shëndetësor, përdorimin dhe diseminimin e strategjive efektive dhe bashkëkohore të komunikimit dhe informimit shëndetësor me qëllimin final përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor, e reflektuar kjo në rritje dhe përmirësim të qëndrueshëm të rezultateve dhe tregueseve shëndetësorë të popullatës së vendit. Është pikërisht ky Departament, ku permbahet nga ana organike dhe funksionale “Magazina e të Dhënave” [“*Data Warehouse*”] e Sistemit të Informacionit Shendetesor të Shqipërisë.

Organigrama (Struktura perberese) e Departamentit të Edukimit dhe Promocionit Shendetesor është në funksion të kaheve/drejtimeve baze të aktivitetit të tij:

Departamenti i Edukimit dhe Promocionit Shendetesor e ushtron aktivitetin e vet në drejtimet e mesiperme në mbështetje dhe funksion të ISHP-se dhe Ministrisë së Shëndetësisë, në baze të planeve përkatëse afat-shkurterë dhe afat-mesme të përpiluara prej tij dhe miratuara nga Drejtoria dhe Këshilli Shkencor i ISHP-se.

Departamenti i Edukimit dhe Promocionit Shendetesor e ushtron aktivitetin e vet në bashkëpunim të ngushtë me Departamentet e tjera shkencore të ISHP-se, Drejtoritë/Sherbimet e Shëndetit Publik në baze Rajoni/Rrethi, si dhe Sektore Publike jashtë sferës së shëndetësisë dhe/ose organizma/organizata të ndryshme jo-publike brenda dhe jashtë vendit.

Drejtimet kryesore të aktivitetit të Departamentit të Edukimit dhe Promocionit Shendetesor janë:

Shërbimi i edukimit shëndetsor dhe promovimit të shëndetit është një sektor i veçantë dhe i specializuar, që është në vartësi të Drejtorisë së Kujdesit Shëndetsor Parësor, të Institutit të Shëndetit Publik, si edhe të Drejtorive të Shëndetit Publik në rrethe.

Departamenti i Edukimit Shëndetsor dhe Promocionit të Shëndetit drejton dhe udhëheq nga ana metodike, didaktike dhe shkencore punën për :

(i) Sensibilizimin e grup-moshave të ndryshme për mbrojtjen dhe forcimin e shëndetit të tyre nëpërmjet forcimit të veprimtarisë edukativo-shëndetsore (informuese, edukuese, komunikuese). Për këtë synohet :

- rritja e shkallës së njohurive shëndetsore të publikut rreth shkaktarëve të sëmundjeve dhe masat parandaluese ndaj tyre.
- ndërgjegjësimi i publikut për rolin e edukimit shëndetsor dhe promovimit të shëndetit për mbrojtjen e shëndetit në përgjithësi dhe ndryshimin e sjelljeve të tyre.

(ii) Edukimin shëndetsor të grupeve të ndryshme target dhe më konkretisht të grave shtatëzëna, të nënave të reja, të fëmijëve të moshës shkolllore, të moshës së tretë etj, duke përdorur :

- **edukimin shëndetsor** si një proces i komunikimit ndërpersonal për ndryshimin e sjelljeve mbi shëndetin, pra që njerëzit të mësojnë si t'a fitojnë dhe si t'a ruajnë atë.
- **promocionin e shëndetit** si një proces që u krijon njerëzve mundësitë për të rritur kontrollin ndaj shëndetit të tyre dhe për ta përmirësuar atë, si një veprim i përbashkët i komunitetit.

(iii) Ngritjen e nivelit teoriko-shkencor dhe metodik të punonjësve të vet si edhe të punonjësve të Shërbimit të Edukimit Shëndetsor në rrethe, nëpërmjet shfrytëzimit të dokumentave bazë të OBSH-së, si Karta e Ottava-s, Karta Europiane për Mjedisin dhe Shëndetin, Dokumentin e Alma-Ata-s, Shendet per te Gjithe ne Shekullin e 21-te, etj; të literaturës së gjere bashkëkohore; shfrytëzimit të kontakteve midis specialistëve të

vendit me ata të huaj, pjesëmarrjen në seminare kombëtare e ndërkombëtare si edhe angazhimin e punonjësve në studime të drejtpërdrejta.

(iv) Përgatitjen dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme edukativo-shëndetsore duke punuar për :

- Përgatitjen a materialeve metodike për teorinë dhe praktikën e Edukimit Shëndetsor dhe të Promocionit të Shëndetit.
- Përgatitjen e teksteve tip skenari për konkurse, spektakle dhe veprimtari të tjera.
- Përgatitjen e materialeve të ndryshme edukativo-shëndetsore si buletine, manuale, fletëpalosje, broshura, postera, spote etj.
- Studimin e nivelit të kulturës dhe edukatës shëndetsore të publikut nëpërmjet intervistimeve, vëzhgimeve, grumbullimit të të dhënave, etj.

Detyrat organizative:

- Departamenti i Edukimit Shëndetsor dhe Promocionit të Shëndetit paraqitet si një Departament i veçantë në ISHP dhe si Sektor i Edukimit dhe Promocionit në rrethë është në vartësi të Drejtorive të Shëndetit Publik dhe Drejtorive të Kujdesit Shëndetsor Paresor.
- Ky Departament operon mbi bazën e një plani pune (vjetor, 6–muor dhe muor), të bazuar kryesisht në prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Promocionit Shëndetsor dhe të Shëndetit Publik.
- Ai siguron bashkëpunimin me institucionet e tjera shëndetsore duke shkëmbyer informacione, duke marrë pjesë në aktivitetet e përbashkëta dhe duke organizuar veprimtari të përbashkëta.
- Siguron bashkëpunimin me organet e medias elektronike dhe të shkruar.
- Bashkërendon veprimtarinë me OJQ-të e ndryshme që veprojnë në fushën e shëndetit, qofshin këto të huaja apo të vendit.
- Siguron bashkëpunimin me institucionet arësimore dhe kulturore, si me Ministrinë e Arësimit, Institutin e Studimeve Pedagogjike, Drejtorinë Arësimore, Qendrën Kulturore të Fëmijëve etj.
- Organizon trajnimet mbi teorinë dhe praktikën e Edukimit Shëndetsor dhe Promocionit të Shëndetit, të personelit mjekësor dhe paramjekësor në të gjitha strukturat e shërbimit shëndetsor.

- Nxit, përkrah dhe ndërmerr nisma për studime shkencore në fushën e edukimit shëndetsor të komunitetit.
- Organizon fushata të ndryshme sensibilizuese me rastin e evenimenteve të caktuara shëndetsore, apo edhe për probleme të ndryshme emergjente.

Detyrat tekniko – profesionale te pergjithshme

Departamenti i Edukimit Shëndetsor dhe Promocionit të Shëndetit harton dhe implemeton **programe dhe projekte** për probleme të ndryshme si:

- Promovimi i shëndetit në shkolla
- Alkoolin dhe drogën
- Duhanin
- HIV/AIDS-in dhe IST
- Aksidentet
- Nutricionin
- Mjedisin
- Shëndetin riprodhues
- Shëndetin Mendor

Organizon seminare dhe Ëorkshop-e metodike treguese me tematika të ndryshme.

Organizon aksione edukative–shëndetsore, fushata sensibilizuese, panaire etj, duke kërkuar pjesëmarrjen e institucioneve të ndryshme shëndetsore dhe jo, si edhe angazhimin e komunitetit.

Detyra te vecanta te pergjegjesit

- Organizon dhe drejton veprimtarinë e Departamentit të Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit dhe të Shërbimit të Edukimit Shëndetsor në rrethe.
- Kërkon nga vartësit programet e punës për veprimtarinë edukativo-shëndetsore dhe e miraton atë.
- Analizon veprimtarinë e Departamentit dhe Shërbimit në rrethe.
- Mban lidhje me të gjithë sektorët e shërbimit shëndetsor, arësimor, shoqatat e ndryshme, organet dhe institucionet e medias.
- Mban lidhje të ngushta me administratën shtetërore dhe i raporton mbi veprimtarinë e këtij sektori.

- Organizon dhe drejton veprimtarinë për efektivitetin punës edukativo – shëndetsore.

Detyra te specialisteve

- Të punojë për aftësimin e vazhdueshëm profesional.
- Të hartojë planin e punës mujor, 6 – mujor dhe vjetor dhe t'a paraqesë atë tek përgjegjësi i vet.
- Të raportojë për detyrat dhe punën e vet rregullisht tek përgjegjësi.
- Të përgatisë dhe të zhvillojë seminare periodike lidhur me projekte të ndryshme që ndjek.
- Të përgatisë materiale të ndryshme edukative dhe të planifikojë mënyrën e përdorimit dhe të shpërndarjes së tyre.

8.5. DEPARTAMENTI I SHENDETIT DHE MJEDISIT

Ky departament perbehet nga seksione dhe laboratore per kontrole kimiko-analitike dhe mikrobiologjike te ujit, ajrit, mjedisit, ushqimeve e tj.

Seksioni i fizikes Sanitare

- personat që punojnë në këtë sektor duhet te njihen me ligjshmerine per sektorin ku punojnë, per kodin e punes, per standartet shteterore dhe standartet nderkombetare.
- Te njihen me rregullat e brendshme te seksionit dhe ti zbatojnë ato, te propozojne dhe punojne ne vazhdimesi ne lidhje me permirësimin e legjislacionit, standarteve, normave duke patur parasysh perafrimin e tij me legjislacionin e **BE-se** .
- Te zhvilloje pune kerkimore per shtrimin dhe futjen e metodave bashkekohore keto nepermjet temave studimore qe realizohen.
- Te bashkepunoje me seksionet e tjera .
- Te hartoje programe trajnimi dhe te organizoje seminare ne lidhje me indikatorët e ndotesve fizik ne shendetin publik me specialistet e rretheve ne fushen e shendetit publik.
- Te marre pjese ne ekspertizat sanitare te subjekteve te ndryshme,te mbaje dekuamentacion te rregullt per to, si dhe per gjithë aktivitetin e seksionit sipas rregullave te pranuar.dhe ne fund te beje vleresimin e tyre.
- T'i transmetoje njohurite e tij pjesetareve te stafit me te cilet punon.

Seksioni te Ujit dhe Sanitetit

Ne fushen e kerkimit shkencor:

- Si qender reference shkencore e kerkimeve ne fushen e Ujit dhe Sanitetit ka per detyre te beje studime dhe hulumtime ne lidhje me vleresimin e rrisqeve mjedisore te demshem qe lidhen me ujin dhe sanitetin, impakti ne shendet.
- Studime ne ujesjellsa, ne shkarkime te lengeta urbane dhe industriale teknologjine e pastrimit te ujrave shkarkues etj.
- Organizon kontrollin e gjendjes teknike te veprave me karakter sanitar (kaptazhe, depo, linjat e jashtme dhe te brendshme te ujesjellesit) dhe gjendjen e sistemit te kanalizimeve.
- Kryen studime ne fushen e higjenes se vendeve te banuara, me planifikimin e qyteteve dhe fshatrave, me problemet e materialeve ndertimore te banesave etj.

- Ne lidhje me studimet e kryera te shkruaje dhe te botoje artikuj shkencore ne revista dhe buletine brenda dhe jashte vendit, si dhe paraqitja e tyre ne seminare dhe konferenca te ndryshme brenda dhe jashte vendit.

Ne fushen e legjislacionit

- Te njohe legjislacionin ne fuqi ne lidhje me fushen ne te cilin punon, te zbatoje me perpikmeri detyrat te cilat rrjedhin prej tij .
- Te propozoje dhe te punoje ne vazhdimesi ne lidhje me permiresimin e legjislacionit, standarteve dhe normave duke patur parasysh perafrimin e tij me legjislacionin e **BE-se**.

TE TJERA

- Si qender reference shkencore e ekspertizave ne fushen e analizes mjedisore dhe shendetesore, kryen ekspertiza me karakter higjieno-sanitar ne rrethe.
- Ofron ndihme tekniko-profesionale per specialistet e shendetit publik, sherbimit te higjenes dhe Inspektoriatit Sanitar Shteteror ne rrethe, ofron trajnimin dhe kualifikimin e specialisteve te sherbimit te higjenes dhe ISSH-se ne rrethe me ane te seminareve dhe prane Seksionit ne fushen e ujit dhe sanitetit, merr pjese ne to.
- Ndjek ne menyre te vazhdueshme dhe mban nen kontroll te vazhdueshem te situaten higjieno-sanitare te ujit te pijshem ne vend nepermjet analizes se te dhenave

qe vijne nga rrethet , ben vleresin e faktoreve te rriskut ne lidhje me monitorimin e ujit te pijshem.

➤ Pergatit ne menyre periodike(mujore) Buletinin e Ujit te Pijshem dhe e dergon ate ne Institucionet Qendrore dhe ne te gjitha DSHP-te e rretheve.

➤ Pergatit ne vazhdimesi informacione shkencore ne fushen e ujit dhe sanitetit per dikastere te ndryshme Shteterore Qendrore dhe Lokale me qellim informacioni, sensibilizimi dhe vemendje me te madhe ndaj problemeve te ujit te pijshem nga ana e tyre me qellim reduktimin e ekspozimit te popullates ndaj faktoreve te demshem qe lidhen me ujin e pijshem.

➤ Organizon, studion dhe merr masa per zbatimin e Programit Kombetar te Monitorimit te Mjedisit, mbi monitorimin e ujit te pijshem dhe ujrave siperfaqesore, ne bashkepunim dhe te ofruar nga donatore te huaj, vendas, sipas Vendimit Nr. 103, date 31.03.2002.

➤ Organizon dhe kontrollon punen per marrjen e masave te nevojshme per Seksionin me qellim funksionimin ne menyre te rregullt e te shpejte te gjitha kerkesave emergjente qe paraqiten ne lidhje me ujin e pijshem.

➤ Organizon punen per shperndarjen e mostrave te ujrave ne te gjitha laboratoret e Depart. harton treguesit analitike per secilin laborator, bashkepunon dhe konsultohet me specialistet e ndryshem mikrobiologe dhe kimiste per probleme te ndryshme ne lidhje me rezultatet analitike.

➤ Pergjigjet ne kohe per te gjitha kerkesat e bera nga subjekte shteterore dhe private per ekzaminime laboratorike dhe vleresime analitike te ujrave. (Pergatitja e Raport-Analizave te ndryshme ne lidhje me kete problem dhe futja e te ardhurave dytesore nga te tretet).

➤ Ne rolin e Inspektorit Sanitar Shteteror te Republikes, merr masa administrative per Ndermarrjet e Ujesjellesit, ne rastet e verejtura te mosrespektimit dhe moszbatimit te Ligjit per Inspektoriatin Sanitar Shteteror ne lidhje me mos sigurimin e ujit te pijshem higjienikisht te paster per popullaten.

➤ Specialisti i seksionit organizon, zbaton, drejton dhe siguron mbarevajtjen e punes ne Seksion me te gjitha detyrat dhe udhezimet qe i ngarkohen nga Shefi i Departamentit.

Kuadrit i mesem ne kete seksion :

- Zbaton te gjitha detyrat dhe udhezimet qe rrjedhin nga rregullorja e Seksionit dhe detyrat e ngarkuara nga kuadri i larte.
- Ploteson flete shoqerimin dhe mban regjistrin e mostrave te ujrave (duke perfshire dhe shkarkimet e ngurta dhe te lengeta industriale si dhe ato urbane), dhe i dergon ato ne labororet perkates sipas kerkesave per analiza.
- Kujdeset per dokumentacionin e Seksionit dhe mirembajtjen e tij.
- Ne ekspertizat e realizuara ne rrethe ne perberje te grupit te punes dhe ne programet e ndryshme studimore, realizon marrjen e mostrave te ujrave dhe mbeturinave sipas kerkesave per marrjen e mostrave.
- Mbledh te dhenat analitike nga te gjitha labororet, pergatit dokumentacionin per hartimin e Raport-Analizave dhe hartimin informacioneve te tjera nga kuadri i larte.
- Merr pjese aktive ne mbledhjen e informacioneve (fishave) nga rrethet, pergatit te dhenat e fishave te ardhura nga rrethet ne baze te kerkesave te kuadrit te larte per pergatitjen mujore te buletinit te ujit te pijshem .
- Hedh te dhenat ne kompjuter (operatori) gati per perpunimin, vleresimin dhe hartimin e Buletinit te Ujit te Pijshem nga kuadri i larte.
- Marrin pjese ne te gjitha temat studimore dhe programet e hartuara nga kuadri I larte.
- Marrjen e masave te nevojshme per Seksionin me qellim funksionimin ne menyre te rregullt e te shpejte te gjitha kerkesave emergjente qe paraqiten ne lidhje me ujin e pijshem.(Pergatitja e bazes materiale te nevojshme per rastet emergjente)
- Siguron furnizimin e vazhdueshem me baze materiale ndihmese per punen ne Seksion.

DETYRAT E STAFIT ANALITIK TE LABORATORIT TE KIMISE ANALITIKE

Specialisti

- Duhet te kete njohuri per ligjshmerine, per sektorin ku punon, (shendetesi dhe mbrojtje mjedisi), per procedurat e gjykates, per kodin e punes, per standartet shteterore, standartet nderkombetare etj.

- Duhet te njohet rregullat e brendshme te laboratorit (sigurimin teknik, metodat e punes etj) dhe ti zbatoje ato.
- .Eshte pergjegjes per menaxhimin e teknikave laboratorike me te cilat punon, per mirembajtjen e pjeseve, kalibrimin e metodave, furnizimin me pjese nderrimi e materiale konsumi (lajmeron shefin e laboratoreve per difektet dhe nevojat per mirembajtje per teknikat laboratorike).
- Duhet te paiset me certifikate per perdorimin e aparaturave dhe teknikave speciale me te cilat punon.
- Gjate trajnimit per nje teknike te caktuar duhet te jete nen supervizionin e nje personeli me eksperience dhe te trajnuar me pare.
- Te hartojte PSP (procedurat standarte te punes ose SOP nga anglishtja) per analizat qe mbulon
- Te ndihmoje ne perlllogaritjen e kostos se analizave te reja, se bashku me financieret e ISHP.
- Te hartojte kerkesat periodike per mjete ndihmese, reagente, qelqurina, pjeset kembimi, materiale konsumi etj., per analizat dhe teknikat qe mbulon dhe t'ja paraqese shefit te seksionit te laboratoreve.
- Te ndihmoje shefin e laboratoreve per hartimin e kerkesave vjetore per reagente, standarte, kete, qelqurina, pjeset kembimi etj.
- Te mbaje dokumentacion te rregullt per teknikat dhe per rezultatet e analizave te kryera sipas GLP (praktikes se mire laboratorike, nga anglishtja) dhe standartit ISO 17025.
- Te mbeshtese seksionet e ndryshme te departamentit duke i furnizuar me analiza te substancave gjurme (metale te renda, mikrondotesit organike si pesticide klororganike, hidrokarbure etj), te aprovuara nga bordi drejtues i ISHP per mostrat ushqimore, mjedisore dhe biologjike.
- Te mbeshtesi me analiza kimike, per treguesit e aprovuar, ne rastin e ekspertizave dhe emergjencave per shendetin publik.
- Te zhvilloje pune kerkimore per shtrimin dhe futjen e metodikave bashkekohore te analizave.
- Eshte pergjegjes per perpunimin e mostrave (pregatitjen , pastrimin, koncentrimin) dhe analizimin sipas metodikave te aprovuara (standarte ose jo) dhe per validimin e metodave analitike me te cilat punon.

- Te shkruaje raport analizat ne funksion te rezultateve dhe rekomandimet ose verejtjet qe mund te lidhen me ndonje konstatim te verejtur ne moster dhe ti firmose ato.
- Ndalohet maredhenia direkte e analisteve me klientet, si per marrje mostre ashtu edhe per dhenie pergjigje te rezultateve te analizave.
- Te ruaje konfidencialitetin e rezultateve te analizave
- Eshte pergjegjes per menaxhimin e mostrave ne nivel laboratorik, (ruajtjen para dhe pas analizes dhe dokumentimin).
- Te mbaje dokumentacion te rregullt mbi gjithe aktivitetin e laboratorit sipas rregullave te pranuar.
- Te kujdeset per evadimin e rregullt te mbeturinave te demshme te analizave sipas rregullave nderkombetare per mbrojtjen e mjedisit.
- Te hartoje programe trajnimi dhe te organizoje kurse specializimi dhe rifreskimi per kimistet e rretheve , qe te mbaje ne korent rrjetin kombetar te laboratoreve te shendetit publik.
- Te marre pjese ne kontrollin e punes se laboratoreve te rretheve.
- Ti transmetoje njohurite e tij/saj pjestareve te tjere te ekipit analitik (si per kuadrot e larte, ashtu edhe per tekniket apo laborantet, perfshi edhe udheheqjen e e temave te diplomave universitare)
- Ne rast largimi te perhershem nga vendi i punes , kimisti dorezon me inventar te rregullt, gjithe materialet teknike, aparaturat per te cilat ka qene pergjegjes, si dhe dokumentacionin perkates (instruksione perdorimi, mirembajtje, SOP etj) si dhe materialet didaktike, artikujt shkencore, botimet, informacionet (ne arshive te ISHP) etj. qe ka kryer gjate kohes se punes ne laborator.

DETYRAT E STAFIT TE MESEM TE LABORATORIT TE KIMISE ANALITIKE

- Te njohin dhe te zbatojne rregulloren e brendshme te laboratoreve dhe ate te ISHP (per sigurimin teknik, metodat e punes, detyrat dhe funksionet etj).
- Te asistojne kimistat e larte ne punen e tyre me analizat kimike duke marre pjese aktivisht ne analize.

- Te kryejne analiza kimike per te cilat jane trajnuar dhe kualifikuar nga stafi kimist i larte.
- Te mbajne shenime te rregullta per pregatitjen e solucioneve dhe reagenteve te punes ne regjistrat perkates.
- Pergjigjen per larjen dhe trajtimin e qelqurinave te punes sipas metodikave specifike analitike, qe kerkon ky laborator.
- Pergjigjen per perdorimin , mirembajtjen, rigjenerimin e sistemit te prodhimit te ujit te dejonizuar dhe suprapur se bashku me laborantet e mikrobiologjise.
- Te sigurojne furnizimin e vazhdueshem me uje te dejonizuar dhe suprapur, per laboratorin.
- Te bejne rigjenerimin e solventeve, qe perdoren ne teknikat ekstraktuese ne laborator, nepermjet distilimit periodik te tyre.
- Te pergatisin solucione te punes per analiza te vecanta , per te cilat jane kualifikuar dhe ti dokumentojne ne regjistrat perkates.
- Te mbajne paster vendin e punes, te bejne pastrimin periodik te pergjithshem te laboratorit, te pergjigjen per pastertine dhe mbajtjen e rregullit ne pergjithesi ne laborator.
- Te bejne furnizimin periodik te laboreve me materiale ndihmese dhe konsumi dhe te mbajne dokumentacion te rregullt , per kete.
- Te marrin pjese aktive ne inventarizimet vjetore te laboratorit ne bashkepunim me administratorin e departamentit dhe komisionin e inventarizimit.
- Te mbajne dokumentacion te rregullt (proces verbale) per nxjerrjen jashte perdorimi te qelqurinave apo mjeteve te tjera ndihmese.
- Te menaxhojne reagentet dhe qelqurinat ne laborator duke mbajtur dokumentacion te rregullt per vend-ndodhjen , per harxhimin dhe te vene ne dijeni kimistet per nevojat per furnizim.
- Te mbajne nje dokumentacion te vecante per harxhimin e solventeve qe perdoren me shumice (acetone, heksane, diklorometan. Acetonitril, metanol etj).
- Ti nenshtrohen testimit periodik te dijenive sipas planeve te hartuara nga seksioni i laboreve.
- Te kontrollojne, monitorojne dhe mbajne shenime per kushtet e punes ne laborator kur kete e kerkon natyra e punes (psh kontrolli i temperatures se frigorifereve).

- Te marrin pjese ne trajnime periodike per metodika te reja pune dhe rifreskim dijesh dhe te paisen me certifikaten perkatese.
- Te kujdesen per mbylljen e rubinetave te ujit, heqjen e prizave te korentit, mbylljen e dyerve dhe dritareve ne perfundim te orarit te punes.
- Ne rast largimi te perhershem nga vendi i punes, laboranti te dorezoje me inventar te rregullt gjithe materialet teknike, aparaturat per te cilat ka qene pergjegjes si dhe dokumentacionin perkates (proces verbalet, dosjet e inventareve, rregjistrat etj) te kohes se punes ne laborator.

DETYRAT E STAFIT TE MESEM NE LABORATORIN MIKROBIOLOGJIK

- Njeh dhe zbaton rregulloren e brendshme te laboratorit te mikrobiologjise (sigurimin teknik, metodat e punes, etj) dhe pergjigjet per punen e kryer ne laborator.
- Kryen procedurat e punes simbas ndarjes se punes qe behet nga shefi i laboratorit dhe merret me mirembajtjen e laboratorit (pergatitje terrene, sterilizime, mirembajtje laboratory, etj), duke pergatitur te gjitha materialet e nevojshme per kryerjen e analizave mikrobiologjike.
- Merr pjese ne mbajtjen e regjistrimin e mostrave, regjistrin e rezultateve te analizave rutinore dhe studimore.
- Merr pjese ne furnizimin e vazhdueshem te laboratorit me materialet ndihmese e te konsumit.
- Kryen te gjitha analizat mikrobiologjike te mostrave mjedisore, te ujrave qe vijne ne laborator, duke zbatuar me perpikmeri procedurat teknike te analizes.
- Mban ne gjendje gadishmerie te gjitha aparaturat e laboratorit.
- C`demton materialet infekte, sipas rregullave te asepsise dhe sterilizimet.
- Menazhon reagentet dhe qelqurinat duke mbajtur dokumentacionin perkates.
- Miremban materialet biologjike qe jane ne ruajtje (kultura mikrobike, shtame, etj.) duke etiketuar cdo gje me llojin e materialit, data e pasazhimit, data e perdorimit ose data e asgjesimit te tyre.

Detyrat e Laborantit Biokikimist ne laboratorin e Mikrobiologjise se mjedisit dhe ujrave

- Njeh dhe zbaton rregulloren e brendshme te laboratoreve (sigurimin teknik, metodat e punes, etj) dhe pergjigjet perpara pergjegjesit te laboratorit per punen e kryer.
- Merr pjese ne temat studimore te laboratorit si ne kryerjen e analizave mikrobiologjike edhe ne perpunimin e rezultateve.
- Kryen procedurat e punes simbas ndarjes se punes qe behet nga shefi i laboratorit dhe merret me mirembajtjen e laboratorit.
- Mban regjistrin e mostrave, regjistrin e rezultateve te analizave rutinore dhe studimore.
- Siguron furnizimin e vazhdueshem te laboratorit me materialet e ndihmese e te konsumit.
- Kryen te gjitha analizat mikrobiologjike te mostrave te ujrave dhe mostrave te tjera mjedisore (uje, ajer toke) qe vijne ne laborator duke zbatuar me perpikmeri procedurat teknike te analizes, si dhe ne aplikimin e metodave te reja te futura ne laborator.
- Pergatit te gjitha materialet e nevojshme per kryerjen e analizave mikrobiologjike.
- Mban ne gjendje gadishmerie te gjitha aparaturat e laboratorit, si dhe aparatit e prodhimit te ujit te dejonizuar dhe bidistile per te gjitha labororet e departamentit.
- Kryen sterilizimin e materialeve te domosdoshme per kryerjen e analizave mikrobiologjike si ç'demton materialet infekte, sipas rregullores te asepsise.
- Menazhon reagentet dhe qelqurinat duke mbajtur dokumentacionin perkates.
- Miremban materialet biologjike qe jane ne ruajtje (kultura mikrobike, shtame, etj.) duke etiketuar cdo gje me llojin e materialit, data e pasazhimit, data e perdorimit ose data e asgjesimit te tyre.

SEKTORI “CILESIA E AJRIT”

Stafi ne Seksionin e Kontrollit te Cilesise se Ajrit:

- Te kete njohuri per ligjeshmerine, per sektorin ku punon, kodin e punes.
- Te realizoje vleresimin e impaktit qe ka ndotja e cilesise se ajrit ne shendetin e popullates.

- Te marre pjese ne ekspertizat sanitare qe lidhen me ndotjen urbane te shkaktuara nga nje sere ndermarrjesh industriale te ndertuara prane qendrave te banimit dhe impaktin qe ka kjo ndotje ne popullaten e banuar prane ketyre ndermarrjeve.
- Te hartoje dhe realizoje tema studimore lidhur me problemet shendetesore qe lidhen me ndotjen (cilesia e ajrit te brendshem dhe te jashtem) nepermjet bashkepunimit dhe me labororet e tjere.
- Te mbajtje dokumentacione te rregullta ne lidhje me aktivitetet e kryera dhe raportimit te tyre parne shefit te departamentit.
- Te realizoje tema seminaresh me specialiste te fushes ne lidhje me implementimin e indikatorëve te mjedisit dhe shendetit (kryesisht cilesia e ajrit) per te dale me mire ne pah lidhja shkak – pasoje.
- Te kete njohuri te standarteve qe lidhen me treguesit e ndotjes se cilesise se ajrit.

Stafi ne Laboratorin e Mikrobiologjise Ushqimore (Laboratori i Bakteriologjise dhe Mykologjise Ushqimore) duhet :

- Te survejoj situaten e prodhimeve ushqimore nepermjet studimeve te ndryshme ne fushen e mikrobiologjise ushqimore ne bashkepunim me labororet e tjere kimik dhe toksikologjik te kesaj fushe , me qellim qe te arijme ne permiresimin e sigurise ushqimore, per mbrojtjen e konsumatorit ne perputhje me standartet e BE, dhe mbi impaktin e tyre ne shendetin e komunitetit.
- Te perpunoj metoda dhe te permiresoj vazhdimisht tekniken e punes laboratorike.*(Ne kete kuader kemi pergatitur nje material me metodat e analizave mikrobiologjike te ushqimeve, si dhe formulat e tereneve perkatese, bazuar tek nje manual sviceran per prodhime ushqimore).*
- Te marre pjese ne ekspertiza, ne raste intoksikacionesh ushqimore.
- Te analizoje prodhimet e reja ushqimore per parastandarte.
- Te analizojme mostrat e ushqimeve per te trete ne baze te kerkesave te subjekteve te ndryshme.
- Eshte pergjegjes per rezultatin e analizave mikrobiologjike dhe dokumentacionin qe lidhet me te.

- Te ndihmojme ne perpilimin e normave, udhezimeve dhe rregulloreve me karakter higjeno-sanitar ne fushen e mikrobiologjise se ushqimeve, si dhe ben sugjerime per normat sanitare ekzistuese.
- Te organizoje shfrytezimin racional te kohes se punes, mirembajtjen e perdorimin racional te aparaturave, reagenteve dhe mjeteve te konsumit.
- Te mbaje te gjitha dokumentacionet qe pasqyrojne anen teknike te veprimtarise se laboratorit.
- Te planifikoje kerkesat mujore e vjetore per reagente, kite, terene, qelqurina etj.
- Te specializojte kuadrot e larte dhe te mesem ne fushat perkatese, etj

Zyra e mbrojtjes nga rrezatimet varet administrativisht drejtperdrejt nga Drejtoria dhe funksionon ne baze te nje rregulloreje te vecante te miratuar nga Bordi Kombetar mbi Rrezatimet.

